


# DRITA

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Mars 2010 • Viti XXVII • Nr. 3 (185) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



**Një meshtar mendjendritur për Kishën dhe kombin**

FAQE 6

Shkruan:  
Dr. Don Shan ZEFI



**Vizita Baritore e Ipeshkvit tonë Imzot Dodë Gjergji**

FAQE 10-11

Shkruan:  
DON ALBERT JAKAJ



**Si sillemi me konfliktin bashkëshortor?**

FAQE 17

Shkruan:  
DR. PAVAO BRAJSA



*Redaksia e revistës “DRITA” gjithë besimtarëve katolikë ua uron për shumë mot Pashkët!*

## Porosia e Ipeshkvit tonë Dodë Gjergjit me rastin e Pashkëve 2010

Drejtuar priftërinjve,  
motrave të nderit,  
besimtarëve dhe  
të gjithë njerëzve vullnetmirë në Kosovë,  
“U ngjall Krishti, shpresa ime”

Fort të dashur,

në pritjen e solemnitetit të Festës së Pashkës së Zotit tonë Jezu Krishtit, e ndjej të nevojshme të vij prapë tek ju me zemër të hapur; që të lexoni e të gjeni në të gjithë dashurinë që kam për ju dhe të shpreh edhe njëherë gëzimin tim që dua ta ndaj me ju me rastin e Festës së madhe të Pashkëve, kur ne festojmë dhe dëshmojmë Ngjalljen e Zotit tonë Jezu Krishtit.

Kremtimi solemn dhe festimi plot gëzim i shpëtimit dhe shpërblimit tonë manifeston triumfin e dashurisë së Hyjit tonë ndaj nesh. “Vërtet, Hyji aq fort e deshi botën sa që dha një të vetmin Birin e vet kështu që, secili që beson në të, të mos birret, por të ketë jetën e pasosur (Gjn 3,16). Hyji, Ati ynë qiellor për dashurinë ndaj bijve që i ka në botë e flijoi të Paralindurin. Jemi të thirrur që të gjithë, të përqafojmë me zemër këtë Dashuri të pakufishme që Ati ka shprehur ndaj nesh dhe ta sodisim deri në pafundësitë e thellësisë së zemrës, nga e cila pastaj duhet të burojë përgjigjja, me dashuri ndaj Dashurisë që na u është zbuluar dhe dhuruar neve.

Kisha, në festimin e përvjetshëm të Pashkëve kremton, dëshmon dhe e shpallë solemnisht Ngjalljen e Zotit tonë Jezu Krishtit nga të vdekurit dhe me plot shpresë, gëzueshëm i fton të gjithë njerëzit, që të ecin bashkë me të drejt paqes së vërtetë në liri dhe drejtësi. Papa Benedikti i XVI në porosinë e tij kreshmore na mëson se: falë angazhimit të Krishtit ne mund të jemi pjesë e drejtësisë supreme e cila shfaqet në dashuri, kurse ne duhet të angazhohemi që kjo dashuri, e cila më shumë dhurohet sesa kërkon shpërblim, të ndjehet në çdo zemër, të shihet në çdo gjë dhe të jetë e pranishme në çdo vend,

Mbështetur në dashurinë vetëmohuese të Krishtit për të vullosur drejtësinë e Zotit në zemrat e njerëzve, ne të krishterët besojmë se: Bashkë me të Ringjallurin, kemi rilindur në jetën e re. Kjo vetëdije na shpie përpara dhe na nxitë për të dhënë kontributin tonë në rindërtimin e një shoqërie që bazohet në themelet e së vërtetës dhe të drejtësisë, ku të gjithë do

**Letnica – oazë shpirtërore për besimtarë**

FAQE 14

Përgatiti:  
Don Kristë GJERGJI

Intervistë me patër Lovro Gavran,  
provincial i françeskanëve të Bosnës

**Tridhjetë vite ndër shqiptarë**

FAQE 12-13





të merrnin të nevojshmen për të jetuar me dinjitet, ku sakrificat dhe vetëmohimi do të shndërrohen në dhurim, e drejtësia do të lartësohet në dashuri. Kjo do të na mundësojë të gjithëve, që pa frikë dhe në paqe të jetonim pranë njëri-tjetrit.

Kisha është përpjekur gjithmonë t'i ngushëllojë njerëzit për padrejtësitë dhe dhunën e përjetuar në të kaluarën nga rrëmbyesit e të drejtave tona dhe të tjerëve, nuk duam të heshtim as tani: 11 vite pas Lirisë dhe 2 vite pas Pavarësisë, sepse mbjellësit e padrejtësive, nxitësit e konflikteve, rrëmbyesit e lirive dhe shfrytëzuesit e mundësive tona, edhe pse nuk janë më të njëjtit, lindin ndër ne e po forcohen dita-ditës.

Kjo gjendje, jo që **nuk ndjell mirë** për një të ardhme më të rehatshme dhe për një jetë të re me shpresë, por, ngulfat iniciativën e të drejtëve, cungon të drejtat e të tjerëve, shuan shpresën e të varfërve dhe i lenë në mjerimin e tyre të sëmuarit dhe të moshuarit.

Me shembullin e drejtësisë dhe të dashurisë, ne ftojmë të gjithë njerëzit vullnetmirë në Kosovë, pa marrë parasysh se çfarë roli kryejnë në shoqëri ose çfarë përgjegjësisë kanë për jetën dhe të ardhmen tonë të përbashkët, t'i lejojnë zemrat të transformohen nëpërmjet dashurisë së të Ringjallurit, që është masa më e mirë për drejtësinë që mund ta ushtrojmë ose të drejtat që duhet t'i respektojmë ndaj të tjerëve.

Me këto mendime dhe dëshira: Uroj Pashkët - Ngjalljen e Jezu Krishtit, që për ne ka domethënie të mirës, të drejtës, të vërtetës, drejtësisë dhe dashurisë, si zgjidhja e vetme për ne dhe për botën e sotme.

Për shumë mot Pashkët!

+ Dodë Gjergji  
*Ipeshkvi i juaj*

## Atë Luigj Palaj, në përvjetorin e martirizimit për Fe e Atdhe

Më 7 mars 2010, famullia e Zymit e përkujtoi martirin e kishës katolike atë Luigj Palaj, të vrarë më 7 mars 1913 në Janosh të Gjakovës.

Ishte koha e luftërave ballkanike, kur Mbretëria e Malit të Zi kishte pushtuar trojet e Kosovës dhe kishte koncentruar një ushtri të madhe në Rrafshin e Dukagjinit. Pos që Mali i Zi provonte të ndërroj kufijtë, provoi të ndërrojë edhe fenë këtij populli këtu. Ishte atë Luigji, "ai i cili u bë gurë në të cilin zihet në thua e thyhet qafa".

Pasi u vorros aty ku u vra, disa muaj më vonë e rivarrosën në varret e kishës së shën Prenës në Bytyç (sot Karashëngjergji) në famullinë e Zymit.

Në atë kohë atë Shtjefën Gjeçovi filloi t'i mbledhë dëshmitë për martirizimin e frtit të Glllogjanit-patër Luigjit.

Meshën në mot me borë e udhëhoqi ipeshkëvi i Kosovës Mons. Dodë Gjergji, së bashku me sekretarin don Albert Jakaj, famullitarin e Zymit don Ndue Balabanin dhe Patër Ndue Kajtazi. Pos besimtarëve të Zymit kishin ardhur një numër i madh nga famullia e Gjakovës. Nga aty ishin në lutje edhe anëtarët e Rregullit të Tretë Shekullar Françeskan të Gjakovës. Ipeshkëvi në predkun e rastit foli për figurën e ndritur

të këtij martiri që jetoi e vdiq për Krishtin dhe fenë e shenjtë katolike. Me pietet i kujtoi edhe meshtarët e tjerë të rënë kudo, e në veçanti foli për rolin e françeskanëve në ruajtjen dhe kultivimin e besimit të shenjtë në këto troje.

Patër Luigji Palaj OFM, është në listën e 40 martirëve shqiptarë që presin nga kisha beatifikimin. Pesë nga këta janë nga Kosova, dhe është i vetmi martir, eshtrat e të cilit gjinden në territorin e Kosovës.

(Dritapress)

### Atë Luigj Palaj OFM

Atë Luigj Palaj lindi në Janjevë (Kosovë), në ipeshkvinë Shkup-Prizren, më 21 shkurt 1879.

Pas shkollë fillore në vendin e lindjes, u transferua në Shqipëri ku hyri në familjen rregullare të Fretërve Minorë, në Kuvendin e Troshanit (Lezhë).

Në Troshan bëri noviciatin. Vazhdoi studimet filozofike në Itali gjatë viteve 1896-1901.

U shugurua meshtar më 21.09.1901. Pas shugurimit shërbeu në Kosovë, në famullinë e Pejës dhe të Glllogjanit, si edhe në shenjtëroren e shëna Ndout në Gjakovë. Ndërroi emër nga Mati në Luigj, sepse ishte shumë i prekur nga jeta e Shën Luigj Gonzagës.

Pas shugurimit meshtarak u ndal në Romë edhe për dy vite të tjera për studimi pas-universitare.

Gjatë viteve 1905-1907 qe famullitar në Arqipeshkvinë e Shkodrës. Gjatë viteve 1907-1912 u emërua rektor i shenjtërores së shën Antonit të Gjakovës (Kosovë).

U martirizua në Janosh afër Gjakovës, për faktin se nuk pranoi të bëhej prift ortodoks, më 7 mars 1913, ku përkohësisht edhe u varros. Trupi i tij më vonë u transferua në varrezat e Shën Gjergjit, në famullinë e Zymit. Jetoi duke dëshmuar fenë në Zotin, ideat dhe të vërtetën për fe e atdhe.



## Në Ferizaj, u përkujtua 25-vjetori nga kalimi në amshim i don Gaspër Gjinit



Don Viktori, me një stil meditativ, duke lidhur figurën e don Gasprit me vetë porosinë e kësaj të diele, foli mbi jetën e don Gasprit mbi punën e tij madhore dhe figurën e tij poli-antike e te cilën e konsideroi si dhuratë për këtë kishë dhe popullin tonë martir, mbi punën e tij shkencore, ku mund të bëhen me dhjetëra e dhjetëra disertacione dhe punime shkencore mbi identitetin e popullit tonë dhe ecjen e tij shume shekullore, nga një punë aq e përkushtuar drejt idealit të ndriqimit e identitetit shqiptarë. Kisha apo populli shqiptar gjatë shekujve.

Në meshë ishin prezentë dy vëllezërit e don Gasprit, Gjergji dhe Luigji me familjet e tyre dhe motra e don Gasprit Marija për të cilën u shpreh don Viktori se është një ndër mësueset më të dalluara në Ferizajin tonë në këtë ditë kur kremtohet edhe dita e mësuesit. Familjarët e të ndjerit don Gaspër Gjinit dhe një numër i konsiderueshëm i besimtarëve, të cilët me vemendje dhe nostalgji nga fjalimi i don Viktorit përkujtuan don Gasprin si meshtar të tyre, si veprimtar i dalluar në Kishën Katolike dhe në shoqërin tonë shqiptare.

Familja me respekt është shprehur pas meshës duke e falendëruar Kishën Katolike dhe Famullitarin për gjithë atë që është bërë në lutje për don Gaspër Gjinit.

(Dritapress)

## Ipeshkvi i Kosovës nderoi heroin kombëtar në Prekaz

Më 7 mars 2010, Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, në përcjellje të bashkëpunëtorëve dhe të disa besimtarëve katolikë, e bëri një vizitë në Prekaz, ku u nderuan të gjithë ata që u flijuan për lirinë e Kosovës, në krye me heroin tonë kombëtar Adem Jasharin. Më pas ipeshkvit dhe bashkëpunëtorëve të tij u rezervua një pritje e ngrohtë në Odën e Jasharajve.

Me këtë rast ipeshkvi vlerësoi lart sakrificën e këtyre familjeve për lirinë dhe pavarësinë e vendit, duke u premtuar lutjet e Kishës për të gjithë ata që dhanë jetë.

Në fund të vizitës Imzot Dodë Gjergji, i dhuroi familjes Jashari një portret të Nënës Ter-eze.

(Dritapress)





# Të Martet e shna Ndout në Gjakovë

Për të gjithë të devotshmit e shenjtët të mrekullive kanë filluar të martet e shna Ndout. Të gjithë ata besimtarë që kanë dëshirë të marrin pjesë në 13 Martet e shna Ndout (shën Antonit) në Gjakovë, të cilat kanë filluar me 16 mars 2010, mesha e shenjte është në ora 10:00.

Ju të tjerët që nuk keni mundësi të merrni pjesë, ju njoftojmë që mesha do të transmetohet drejtpërdrejtë përmes valëve të Radio Marisë, nga studio në Gjakovë.

Meshët në këtë vit gjatë marreve të shna Ndout do t'i udhëheqin këta meshtarë:

- Patër Ndue Kajtazi
- Don Izak Dodës
- Don Albert Jakaj
- Don Marjan Ukaj
- Don Robert Jakaj
- Don Nikson Shabani
- Don Pal Tunaj
- Don Kristë Gjergji
- Don Jeton Thaqi
- Don Ndue Ballabani
- Don Kelmend Spaqi
- Don Marjan Marku
- Don Tomë Karrica

Secili meshtar e ka edhe temën e caktuar ku do të përqendrohet gjatë predikimit. Të martet tani më janë bërë një takim i rëndësishëm për besimtarët tanë. Urojmë që edhe këtë vit këto takime të jenë sa më të frytshme për Kishën dhe mbarë besimtarët.



## Lutja e shna Ndout

O i lumi e i mrekullueshmi shenjtë shna Ndue, gjithë bota e dëshiron madhërinë tënde. Të mëdhenj e të vegjël, pleq e të pasur e të papasur, të gjithë tregojnë huret e shumta e të mrekullueshme, që kanë nxjerrë prej Zotit nëpër lutjet tua. E kushtet, që lehen përpara fytyrës sate si nderim ngadhënjimi, dhuratat që rrethojnë e stolisin përherë altarin tënd, a s'e bëjnë dëshmi pushtetit tënd e fuqinë e lutjeve tua para të Lartit Zot?

Edhe ne, pra po vijmë të përmbysimi ndër këmbët tua e

të porosisim një punë, që ne kemi për zemër sa kurrë një tjetër. Ne e dimë se jemi mëkatarë të mëdhenj e nuk meritojmë që t'i sjellësh sytë e tu të dashur prej nesh; por denjohu të këqyrësh me sy të dhembshëm mjerimin, në të cilin gjendemi.

Po vijmë pra, te ti duke shpresuar në mbrojtjen tënde, po të lypim huret që dëshirojmë. Deh, bën që mos të thuhet, se njerëz të shkretë, si jemi ne, kemi ardhur te ti e nuk na i ke plotësuar lutjet tona. Por bëj që edhe ne të bashkohemi me tjerë për të lumturuar e për t'u falënderuar. Amen.



## Gjenerali Françeskan në Gjakovë

Të dielën më datën 21 mars, Kuvendin Françeskan në Gjakovë e vizitoi gjenerali françeskan patër Josá Rodriguez Carballo.

Për ta pritur gjeneralin françeskan në Gjakovë kishte ardhur edhe provinciali i françeskanëve të Bosnjës patër Lorenci (Lovro Gavran), i shoqëruar nga definitori patër Mato Topić.

Kjo ishte vizita e parë e ndonjë ministri gjeneral që i ka bërë Kosovës. Gjenerali Rodriguez Carballo vizitën e tij e filloi më së pari në Shqipëri për të vazhduar në Tuz (Mali i Zi) dhe pas vizitës që i bëri Kuvendit tonë në Gjakovë vazhdoi përsëri për në Shqipëri.

Së bashku me gjeneralin ishte edhe definitori gjeneral patër Vincenzo Brocanelli, të cilët gjatë gjithë kohës i shoqëroi provinciali i provincës Françeskane Shqiptare patër Gazmend Tinaj.

Të dielën herët në mëngjes bashkësia françeskane e Gjakovës pati një takim me gjeneralin, ku u bisedua për gjendjen e tanishme të Kishës, Rregullit

Josá Rodriguez Carballo gjatë vizitës së tij në Gjakovë



Françeskan dhe për ardhmërinë e saj në trojet shqiptare duke përfshirë Kosovën dhe Malin e Zi.

Pastaj edhe anëtarët e Rregullit Françeskan Shekullar u takuan me ministrin gjeneral.

Në orën 10:00 të gjithë françeskanët së bashku me klerin diocezan kremtuan një meshe në prezencën e madhe të besimtarëve.

Në emër të Rregullit Fran-

çeskan Shekullar dhe besimtarëve të famullisë së Gjakovës, ministrin gjeneral e përshëndeti Lizabeta Nushi.

Ky ishte gjenerali i parë françeskan që erdhi në Kosovë por jo edhe në Shqipëri, sepse themeluesi i Rregullit Françeskan Shën Francisku i Asizit qysh në shekullin XIII kishte qenë në Shqipëri dhe kishte themeluar Kuvendin e parë Françeskan në Lezhë.

## Seminar shpirtëror në famullinë e Gllaviçicës

Nga data 10 deri më 14 mars u mbajt seminari shpirtëror në Kishën e Shën Pjetrit e Palit apostuj në Poterç, famullia e Gllaviçicës.

Seminarin e udhëhoqi Dr. Don Prekë Lazri, drejtor i Radio Marisë në gjuhën shqipe më seli në Shkodër.

Në këtë seminar shpirtëror kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i besimtarëve (mbi 120 persona). Pjesëmarrësit, e gjithashtu edhe famullitari u ndanë jashtëzakonisht të kënaqur me përvojën shpirtërore

që përfituan gjatë këtij seminari. Kjo nuk ishte hera e parë që don Prenka mbajti këtu në seminar pasi që kishte mbajtur edhe disa herë më parë kur famullitar ishte don Marjan Ukë Uka.

Gati në përfundim të seminarit të pranishmëve ju dha mundësia e pranimit të sakramentit të pajtimit – rrëfimit, të cilin e ndan meshtarët: Don Marjan Ukë Ukaj, Don Tomë Gjurgja, Patër Ndue Kajtazi dhe don Jeton Thaqi.

Ky seminar përfundoi më meshën përfundimtare - falënderuese të dielës në ora 11:00 në Poterç që i priu don Preka në bashkë-mëshim me famullitarin.

Famullitari, Don Pal Tunaj falënderoi don Prenkën, pjesëmarrësit dhe uroi që kjo përvojë e mirë e besimtarëve të shërbejë për shenjtërimin e mbarë famullisë, madje edhe të mbarë kishës lokale.

(marrë nga [www.kisha-katolike-gjakove.com](http://www.kisha-katolike-gjakove.com))





# U festua Shën Jozefi, pajtor i kishës në Stubëll

Në këtë ditë të bukur, Stublla ishte plot ngrohtësi për shtegtarët e shumtë që nderojnë shenjtin mrekullibërës Shën Jozefin. Në fytyrat e besimtarëve shkëlqente gëzimi dhe çdo rrugë ishte përplotë besimtarë të drejtuar drejt Kishës kushtuar Shën Jozefit.

Mesha solemne filloi në orën 11.00, të cilën e udhëhoqi don Viktor SOPI, famullitar i Ferizajt dhe drejtor Gjeneral në Caritas-in nacional të Republikës së Kosovës, ku koncelebruan edhe mbi 10 meshtarë.

Në pretkun e rastit, don Viktori me Bibël në dorë citonte shpeshherë Shkrimin Shenjt... Jakobit i lindi Jozefi, fati i Marisë, prej së cilës lindi Jezusi që quhet Krisht (Mt. 1.16).

Njeri që ka vend në Bibël, vepër për të cilën fletë Bibla. Drejtësi që dëshmon me veprim konkret për të cilën flet Shkrimi Shenjt... Tani Jozefi, i fejuari i Marisë, po ai që ishte njeri i drejtë e nuk donte ta çnderonte botërisht, mendoi ta linte fshehurazi (Mt. 1.19-24).

Që nga Bashkësia e parë, njerëzit vullnetmirë frymëzoheshin në figurën e Jozefit... edhe këtu dhe pikërisht këtu në këtë hapësirë e tokë të dëshmisë e sakrificës Shën Pali i kohës së Jozefit mbolli farën e nderimit për këtë shenjtë.

Kështu gjatë gjithë shekujve, kjo figurë u nderua vazhdimisht, figurë kjo aktive në realizimin e vullnetit të Hyjit për të marrë ngryk njeriun e lodhur, të

Don Viktor Sopi gjatë predikimit



habitur... Kështu e nderon edhe Mesjeta... e nderojnë etërit e Kishës... Shën Augustini, Shën Bonaventura, Shën Toma i Akvinit, Shën Bernardi, Shën Izidori, Shën Tereza e Akviles.

E nderojnë si krejt te veçantë pasardhësit e Shën Pjetrit, shumë Papë nga Selia e Shenjte

apelojnë për nderimin e veçantë ndaj Shën Jozefit.

Krejt kjo flet dhe dëshmohe kudo në botë, duke hasur në kisha të kushtuara këtij shenjt, sheshe, shkolla e qytete të tëra, duke përjetuar fuqishëm ndërmjetësinë e Tij.

Vlen të përmendet se vetëm

rregulli Karmelitan ka mbi 150 Kisha të kushtuara Shën Jozefit...

Edhe këtë kishë nuk e ndër-tuan hipotezat por dëshmia dhe besimi i të parëve tanë... ajo dashuri e tyre u bë vepër... ishte i robëruar fiziku i të parëve tanë për të lëvizë lirshëm, për t'u shprehë lirshëm, për t'u lutur në këto hapësira haptazi... por edhe atëherë në zemrën e të parëve tanë vetëm sa u rrit nderimi dhe dashuria ndaj Zotit dhe Shën Jozefit... dhe as kur nuk ia doli as një ideologji që ofronin formula drejt një mirëqenieje, apo konspiratorëve të llojllojshëm që t'ia grabisin nënave dhe baballarëve tanë besimin në Zotin dhe nderimin ndaj mësimit Kris-tian... Dekalogu ishte shkolla, politika, edukata dhe objektivi i tyre.. dhe ja sot ne shpresojmë, se ata gëzojnë jetën duke parë faqe faqas Hyjin.

E ne sot jemi mirënjohës që jemi pasardhësit e tyre... sepse Zoti e kurorëzoi dëshminë, uratën e tyre, kur sot jemi me këtë numër të mirë të thirrjeve meshtarake dhe rregulltare, që është pasuri e veçantë për këtë tokë dhe shoqërinë në përgjithësi, duke vazhduar dëshminë për Atme e Fe, të klerikëve aq të ndritur gjatë historisë sonë!

Edhe ne do të ndërtojmë të mirën nëse kemi kohë për komunikim në thjeshtësi të ndjenjës me zërin e Zotit... edhe ne do të kuptimësojmë çdo moment të jetës, të sakrificës, të sprovave vetëm nëse krijojmë

hapësirë për prezencën e Zotit në jetën tonë. Jo! Vëllezër jeta s'ka kuptim as në të s'ka gëzim, nëse në të vdesin virtytet dhe gatishmëria për flijim...

Njeriu nuk arrin gëzimin e plotë me gjërat konsumuese që ofron në përditshmëri hipokrizia aq anomale e kohës sonë, gjë që kërkojnë epshe tona... krejt çka ofron konsumi përfundon dhe asgjësohet në baltë! T'i krijojmë objektivist gjërat që nuk janë konsumuese... por të amshuara, dhe ato arriten më shumë sakrificë e sprova, por sjellin një kënaqësi permanente, me të cilat njeriu ndihet i lumtur...

Duajë mbi gjithçka Zotin dhe nderojë të afërmin si vëlla të vërtetë dhe motër të vërtetë... këtu njeriu ndihet vërtet i lumtur dhe zbulon figurën e krijesit Hyji në vetë vetën...

Vlen të theksohet përgatitja shumë e mirë e korit të kishës, i cili me këngët e bukura zmadhoi këtë meshë dhe ditë festive.

Në mbarim të meshës don Herbert Berisha, famullitar, falënderoi besimtarët për aq qetësi të mirë gjatë meshës dhe në veçanti përshëndeti don Viktorin, duke theksuar se pretku i kësaj kremte gëzoi shumë fytyra të kësaj hapësire gjatë shumë shekujve dhe u gëzuan edhe këta gur të kësaj Kise të ujtur me shumë gjak e djersë të të parëve tanë... Pas meshe është shtruar edhe dreka vëllazërore për mysafirët e shumtë.

(Dritapress)

## Ripërtrirja shpirtërore për meshtarë, rregulltarë dhe rregulltare të Dioqezës tonë

Koha e kreshmeve është kohë kthimi, vetëdijësi, kohë e ripërtrirjes së mbarë Kishës, sidomos të personave të shuguruar dhe kushtuar Hyjit në shërbim të Ungjillit në vendin e vet të dërgimit. Kështu

më 27 mars 2010, në Prishtinë u mbajt ripërtrirja e rëndomtë gjatë kohës së kreshmëve në shtëpinë e re të Ipeshkvisë, për meshtarë dioqezan, rregulltarë dhe rregulltare që jetojnë dhe punojnë në Kosovë. I pranishëm

ishte edhe vetë Ipeshkvi ynë, imzot Dodë Gjergji. Meditimin e ka udhëhequr don Fran Sopi, famullitar në Pejë. Tema e meditimit ishte: "Lutja e Jezusit meshtarë, porosia e Tij për ne sot!" Don Frana me gjithë shpirt



theksoi në bazë të porosisë së Jezusit të jemi : "Drita e botës dhe kripa e tokës"! Kisha, bota ka nevojë për neve t'i japim shije, të jemi kripë e mirë e një ditë Jezusi Zot do të vlerësojë se çfarë jam unë si meshtarë, ju si të kushtuar, etj. Të pranishëm ishin më se 60 meshtarë e motra. Pas meditimit ka qenë momenti i lutjes, mundësia për rrëfim dhe në orën 12, mesha shenjte në kishën e shën Ndout, të cilën e udhëhoqi Ipeshkvi, në bashkëkremtim me të gjithë

meshtarët e pranishëm. Në homilinë e vet Ipeshkvi porositi, që këto ditë të jemi të përgatitur sa më mirë në lutje dhe me zellë të dëshmojmë para popullit gëzimin e plotë të Ringjalljes së Zotit tonë, Jezu Krishtit! Pas meshe është shtruar dreka e përbashkët në menzën për të varfërit, pranë kishës dhe jemi ndarë me urimet tona më të përzemërta për festën e Pashkëve.

(m. Antonia S. B.D.H)



Në shenjë të 25 -vjetorit të kalimit në amshim të Dr. Don Gaspër Gjini

# Një meshtar mendjendritur për Kishën dhe kombin

■ SHKRUAN:  
Dr. Don Shan ZEFI

Të shkruash për Dr. Don Gaspër Gjini, i cili tashmë kaloi në amshim para 25 vjetëve, ngjall gjithnjë kujtimin e fortë të nderimit e të dashurisë, sepse sa më shumë që po kalon koha, figura dhe vepra e tij mbi historinë e Dioqezës Shkup-Prizren, po e marrin vendin e merituar në historiografinë, jo vetëm kishtarë, por edhe në atë të përgjithshme. Madje, prej studiuesve po cilësohet si një kryevepër me të arritura të larta shkencore, që i ka munguar prej kohësh popullit.

1. Kush ishte Don Gaspër Gjini? Mbi jetën e veprën e Gjinit, përpos fjalimeve të mbajtura me rastin e varrimit në Ferizaj (shih: “Drita”, nr. 3-4/1985 dhe 5-6/1985) dhe të një artikulli nga tashmë i ndjeri Dr. Engjëll Sedaj (shih: “Tradita dhe letërsia”, Prishtinë 1997, 171-175), gati se nuk është shkruar fare mbi këtë personalitet të shquar të Kishës vendore e të kombit. Ndaj, për sa na lejohet nga natyra e një reviste, siç është kjo e “Dritës”, do të mundohemi (vetëm) shkurtimisht t’i sjellim ca të dhëna nga jeta e tij e hershme e deri kur ndërroi jetë, në moshën 55-vjeçare, më 7 mars 1985 në Beograd, nga një sëmundje e rëndë e kancerit.

Origjina e familjes Gjini, nga ana e t’atit Kola, rrjedh nga Shqipëria Veriore, që e kishin ndërruar vendin për shkak të skamjes dhe, më parë, vendosen në Gjakovën e afërme, e pastaj në Ferizaj, ku edhe Gaspri i vogël u lind, më 24 shtator 1930, dhe, sipas traditës, e pas një kohe të shkurtër, do të pagëzohet në të njëjtin qytet e vit në Kishën katolike të Engjëjve të Rojës. Nëna e tij Dusha, ishte prej Zymit (atje ku ka lindur edhe gjyshja e Nënës Tereze), nga vendi që njihet edhe sot për devotshmërinë e nënave zymjane dhe burrave inteligjentë (si Pal Hasi, Bogdani...). Pra, Gaspri i kishte tiparet e shëndosha (si edhe tetë vëllezërit e tri motra tjera) fetare nga prindërit, që do ta përcjellin tërë jetën, si një Don Gaspër i urtë, i devotshëm, i mençur...!

Jeta nëpër të cilën kaloi ai dhe familja e tij, nuk ishte aspak e lehtë, sidomos kur kihet parasysh varfëria e kohës dhe numri i fëmijëve që u kishte dhuruar Perëndia, ashtu që për babanë ishte vështirë

t’ua siguronte kafshatën e bukës, vetëm me çka fitonte si një shofer kamioni (transporti), ndërsa me kalimin e kohës, kjo gjendje paksa përmirësohet në të mirë, pasi që e kishin hapur, po themi, njëfarë bujtine (kohe). Kjo familje fisnike, vërtet, nuk qe e pasur (materialisht), por kishte dashuri të madhe për fëmijët e vet, sepse me mund të madh i shkolloi të gjithë. Një shembull i mirë e tipik, që familjet shqiptare duhet ta ndjekin edhe sot, siç kanë vepruar edhe të parët tanë, madje me uratë (rozare në dorë), me pjesëmarrje në meshën e shenjtë, në sakramente.... për ta ruajtur identitetin e fetar e kombëtar.

2. Don Gaspri shkollën fillore e kishte kryer në Ferizaj, ndërsa seminarin e vogël në Shkodër, për të vazhduar fakultetin teologjik në Djakovo (Kroaci). Gjatë gjithë shkollimit përmendet si student shembullor i teologjisë. Posa i përfundoi studimet, shugurohet meshtar në Ferizaj, më 2 korrik 1955 nga Imzot F. Çekada, nga një ipeshkëv që kishte bërë shumë për thirrje të shenjtë, me shtegtimet e tija të njohura, edhe si i zdathur nëpër shenjëtoret e kishat e Dioqezës. Dhe Zoti do t’ia plotësojë lutjet e tija të shumta për thirrje, gjegjësisht për ripërtëritjen e Ipeshkvisë me kler vendor, e që Don Gaspri, pa dyshim, premtonte shumë. Duke parë formimin dhe ngritjen e tij intelektuale, i njëjti ipeshkëv do ta emërojë për sekretar të vet personal e më vonë edhe kancelar të ipeshkvisë (në Shkup) dhe këtë detyrë do ta kryejë deri që nuk dërgohet në studime post-diplomike në Romë (1964).

Don Gaspër Gjini, pas një përvoje pastorale (dhjetëvjeçare), dërgohet për katër vite në Romë dhe në afatin e parë arriti ta mbrojë me sukses më të lartë (summa cum laude) tezën e doktoranturës në Universitetin Papnor (*Pontificia Universitas Urbaniana*) me temën: *De fontibus historico-juridicis ecclesiae Scopiensis, Romae 1968 (Mbi burimet historike – juridike të Kishës së Shkupit)*, të shkruar e të mbojtur në gjuhën latine.

Në kohën kur Don Gaspër Gjini kthet në Dioqezë (1968), që tashmë selia ipeshkvnore ishte pa Ordinarin e vendit, vendoset në Ferizaj, dhe atje kryen detyrat e mëparshme, derisa sa nuk emërohen për ipeshkvij Imzot Joakim Herbuti dhe Imzot Nikë Prela në krye të Ipeshkvisë Shkup-Prizren,

njëri Ordinari i vendit e tjetri Sedi Datus. Me ardhjen e tyre bëhen edhe ndërrime në ipeshkvi, ashtu që Don Gaspri emërohet famullitar në Shkup dhe këtë detyrë e kryen derisa Zoti nuk e thirri të kalojë nga kjo jetë (1985). Përveç kësaj detyre, ai emërohet edhe kryetar i gjyqit kishtar, pasi që ishte edhe i vetmi meshtar që kishte doktoruar në *Codex Iuris Canonici*. Edhe këtu duhet të njihet kontributi për formimin e këtij gjyqi të rëndësishëm kishtar, që punoi vite të tëra e përgjegjësi të madhe.


3. Nga jeta e tij meshtarake shumëçka mund të veçohet. Ai ishte, në atë kuptimin më të mirë të fjalës, një prift klasik, një bari i mirë ungjillor, një orator i shquar me predikimet (homilitë) e tij mbi të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen e Kishës. E tërë kjo, ndoshta, do të mund të përmbledhet në një fjalë të vetme: Ai, vërtet, qe një at shpirtëror për grigjën që i ishte besuar, e jo vetëm atë, por edhe njerëzit tjerë që i takonte, pa kurrfarë dallimi feje e kombi, sepse e shihte ndër ta fytyrën e Krishtit, Bariut të mirë.

Siç u përmend edhe sipër, Don Gaspri ishte që nga fëmijëria edhe një njëri i devotshëm, ashtu që i shkoi për dore ta përpilojë një libër uratës: *Shujtja shpirtërore*, KS – Drita 1987 dhe disa botimi tjera), që ka mbetur edhe sot një thesar i vërtetë shpirtëror nga tradita e krishterë e lutjeve (uratave) në popullin tonë, një lloj doktrine e krishterë-popullore, që çdo kush e ka për zemër.

4. Dr. Gaspër Gjini, përveç veprimtarisë meshtarake, ai merrej edhe me historinë e Dioqezës Shkup-Prizren, edhe pse veprën e tij të jetës, nuk e pa sa qe gjallë, por pas një viti, mbasi e kishte dorëzuar në shtyp, do t’i botohej në origjinal (siç e kishte përgatitur) me titull: Skopsko-Prizrenska biskupija kroz stoljeca, KS – Drita, Zagreb 1986, për t’u botuar më vonë edhe në shqip: Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj, Drita 1992, e më vonë edhe në anglisht (1999).

Kjo vepër ishte, siç u përmend edhe më lartë, përveç zgjerimeve të shumta dhe burimeve të reja, fryt i doktoraturës, që me sukses më të lartë e kishte mbojtur në Romë, ku mund të konsultohet edhe sot kjo vepër historiografike për ipeshkvinë tonë.

I madhi Shën Tomë Akuini shkruante se: *Timeo hominem unius libri* (Ia kam frikën njeriut me një



libër), dmth. idetë që vijnë nga një libër ose nga një autor i vetëm. I tillë mund të thuhet se ishte edhe autori Dr. Gaspër Gjini dhe vepra e tij mbi Dioqezën Shkup-Prizren nëpër shekuj, që po konsiderohet nga studiuesit edhe si një enciklopedi e besueshme për të kaluarën e Dardanisë antike, e deri kah fundi i shek. XX (1985).

Ky studim sjell një qasje të re mbarështimi (kronologjik), madje është i veçantë për nga trajtimi shkencor i problemeve që ndërlidhen me të kaluarën e hershme e me atë të mëvonshme (bizantine, sllave e osmane). Analizimi dhe sistematizimi i të dhënave burimore e arkivale, i japin veprës një sintezë mjaftë të qëndrueshme, sepse vetë autori e kishte një përgatitje të lartë shkencore, jo vetëm në histori, por edhe në ato lëmi tjera ku lypet njohuria multidisiplinore (gjeografia, drejtësia, teologjia...), e veçmas të gjuhëve klasike, si latinishtja, gjuhët neolatine e sllave, e Don Gaspri i zotëronte mirë, madje fliste e predikonte edhe gjuhën rome!

Për të arriturat shkencore dhe për dashurinë e tij që pati për popullin e vet, pa dyshim hyn në radhën e klerikëve më në zë, siç ishin imzot Andre e Pjetër Bogadani, imzot Gjon Nikollë Kajtazi, imzot Lazër Mjeda, P. Shtjefën Gjeçovi...

Don Gaspër Gjini ishte edhe një bashkëpunëtor i frytshëm

i “Dritës”, që asokohe botonte një sërë artikujsh nga e kaluara e kishës, e sidomos, mbi gjendjen e katolikëve të dikurshëm në Dioqezën Shkup-Prizren, gjë që ndikuan padyshim tek autori i këtij shkrimi që të doktorojë mbi “Islamizimin e laramanizimin e shqiptarëve gjatë shekujve”, të mbojtur në të njëjtin Universitet Papnor në Romë (1992), pastaj të botuar edhe në shqip, kroatisht dhe së fundi në anglisht.

Për gjitha këto merita, jo vetëm meshatrake e shkencore, por le të themi edhe për ato të thjeshta njerëzore, Don Gaspër Gjini nuk u shpërblye, pos Papës Palit VI, që iu dha një mirënjohje: **student i dalluar**, por jo edhe më vonë, madje as pas vdekjes së tij. Ngushëllohem me Zotin që është kurora e drejtësisë, në të cilën ka besuar Don Gaspri ynë i dashur, ndërsa ne, që dimë t’i promovojmë të promovuarit, na mbetet në ndërgjegje e përgjegjësi të organizojmë një simpozium (ndër) kombëtar për të dhe botën e tij, që e pa nga fillet e krishterimit e deri më sot.

Po e “përfundoj” me një thënie tjetër latine se: *“Victuras genium debet habere liber”* (Një libër për të jetuar, duhet të jetë gjeniale), e libri i Dr. Gjinit, tash për tash dhe pas 25 viteve, mbetet si e tillë, por edhe personi i tij mendjendritur, sepse diti të jetë në shërbim të ndaj Zotit e popullit të vet.



Papa iu drejtohet të rinjve me Mesazhin për Ditën e 25-të Botërore të Rinisë:

# Pavarësisht nga vështirësitë, mos hiqni dorë nga ëndrrat, refuzojeni lirinë pa vlera

“Mosha juaj është pasuri e madhe, jo vetëm për ju, por edhe për të tjerët, për Kishën e për botën”. Me këto fjalë u drejtohet Papa të rinjve, në Mesazhin për Ditën e 25-të Botërore të Rinisë, që do të kremtohet më 28 mars, të Dielën e Larit. Është kremtim në nivel dioqezan. I paraprin takimit të madh botëror të të rinjve, që organizohet çdo dy vjet. Takimi i ardhshëm është caktuar tashmë. Do të mbahet në gusht 2011, në Madrid. Por, të njihemi më hollësisht me Mesazhin e Papës, drejtuar të rinjve në mbarë botën. “Krishterimi nuk është në radhë të parë moral” – pohon Benedikti XVI, duke shtuar se është kryesisht “takim me Jezun Krishtin”. Papa shpjegon: Krishterim do të thotë ta provosh se Krishti na do personalisht e se këtë e bën, edhe kur i kthejmë shpinën. Në këtë dashuri gjendet burimi i gjithë jetës së krishterë – thotë Papa. E pikërisht kjo dashuri na jep forcë t’i kapërcejmë të gjitha provat: zbulimin e mëkateve tona, vuajtjen, çkurajimin. Prandaj Benedikti XVI u drejton të gjithë të rinjve ftesën: “Dëgjojeni zërin e Zotit, i cili ka një plan dashurie për secilin nga ju”.

E prej këndej buron edhe tema e DBR-së së sivjetme: “Mësues i mirë, ç’duhet të bëj për të fituar jetën e pasur?” Është pyetja e të riut pasanik në takimin me Jezusin, takim që – shpjegon Papa – dëshmon qartë vëmendjen e madhe të Krishtit për të rinjtë. Jezusi – vijon Ati i Shenjtë – ka dëshirë ta takojë secilin nga ju personalisht, të nisë dialogun me secilin. Ashtu si i riu i pasur i Ungjillit, që e pyet Jezusin ç’duhet të bëjë, ndoshta edhe ju – vijon Papa – jetoni në situata të vështira, të trazuara, të turbullta, të dhimbshme, që ju shtynë të kërkonin një jetë të re, larg mediokritetit e, me të drejtë, edhe të pyesni: “Si mund të ec në rrugën drejt një jete të vërtetë? Si mund ta realizoj? Ç’duhet të bëj? Ç’plan duhet të hartoj për jetën time?”. Mos kini frikë t’i bëni këto pyetje – shton Benedikti XVI. E sidomos, t’u jepni përgjigje. Ato shprehin aspiratat tuaja, ëndrrat, që i keni në thellësi të zemrave. Zëri i zemrës duhet dëgjuar, duhen bërë përpjekje për t’i realizuar ëndrrat në jetë. E Papa i fton të rinjtë t’ia venë mirë veshin dhe thirrjes për jetën meshtarake, për jetën rregulltare ose familjare, duke shkuar edhe kundër rrymës, në se këtë e kërkon Ungjilli.



Takimi Botëror i Rinisë në Sidacj (2008)

Benedikti XVI kujton se mendësia aktuale propozon një liri pa vlera, pa rregulla, pa norma objektive. Të fton ta kapërcesh çdo kufi, kur është fjala për të realizuar dëshirat e çastit. Po ky lloj propozimi – pohon Papa – në vend që t’i prijë drejt lirisë së vërtetë, e shtyn njeriun të bëhet skllav i vetvetes, i dëshirave të tij të çastit, i idhujve, si pushteti, paraja, kënaqësia e shfrenuar. Papa kujton edhe vështirësitë e botës rinore, të cilat i njeh mirë: “Të rinjve të sotëm – thotë – u duhet të përballojnë probleme të mprehta, pasojë e papunësisë, e mungesës së idealeve e të perspektivave të sigurta për të ardhmen. Pavarësisht nga këto, Benedikti XVI i fton të mos i harrojnë dhuratat, që Zoti i ka mbyllur në zemrën e secilit. I këshillon të rinjtë të përgatiten seriozisht për jetën e të studiojnë, për t’i shërbyer me aftësi të larta profesionale e me bujari, së mirës së përbashkët. I fton gjithashtu të kultivojnë në zemër dëshirat fisnike të vëllazërimit, të drejtësisë e të paqes e t’i vënë me fryt në jetë, talentet e mundësitë e tyre. Pavarësisht nga vështirësitë – u thotë Benedikti XVI të rinjve – mos i humbisni shpresat e mos hiqni dorë nga ëndrrat. Dita, tash-

më e afërt, Botërore e Rinisë, që do ta kremtojmë të Dielën e Larit, është e 25-ta: 25 vjet më parë, Gjon Pali II i hapte udhën asaj, që Papa

e quan “takim i përvitshëm i të rinjve besimtarë në mbarë botën”. Në këtë përvjetor, Benedikti XVI u dorëzon të rinjve porosinë: “Ar-

dhmëria është në duart e atij, që di të kërkojë dhe të gjejë arsye të forta për të jetuar e për të shpresuar”.

## Papa shkon në Mbretërinë e Bashkuar nga data 16 deri më 19 shtatorin e ardhshëm, me ftesë të mbretëreshës

Benedikti XVI do të shkojë për vizitë në Britaninë e Madhe nga data 16 deri në datën 19 të shtatorit të ardhshëm. Kështu lajmëron me anë të një komunikate mbretëresha Elizabeta II. Mbi këtë udhëtim apostolik, i pari i një Pape me statusin e “vizitës shtetërore”, u mbajt në Londër një konferencë shtypi e përbashkët e qeverisë dhe e konferencave ipeshkvnore të Skocisë, Anglisë dhe Uellsit. “Një rast pa precedent për të forcuar lidhjet ndërmjet Selisë së Shenjtë dhe Mbretërisë së Bashkuar përsa u përket nismave globale dhe për të vlerësuar rolin e rëndësishëm të fesë në krijimin e bashkësive të qëndrueshme”: kështu u shprehën ipeshkvijtë për gazetarët.

Papa do të pritë nga mbretëresha Elizabeta më 16 shtator në Pallatin Holirud-hauz në Edimburg të Skocisë. Ati i Shenjtë do të

mbajë një fjalim për shoqërinë civile britanike në Uestminster. Në Koventri do të kremtojë Meshën në të cilën do të shpallet i Lum teologu i madh Xhon Henri Njuman. Momente të tjera të rëndësishme të vizitës do të jenë Meshat në Glasgou, lutja në Londër, takimi me botën e kulturës dhe vizita te kryepeshkvi i Kanterburit dhe primatit të Bashkimit Anglikan në Lambet. Gjithashtu, Papa do të lutet me krerët e besimeve të tjera të krishtera në Abacinë e Uestminsterit. Në një mesazh video në faqen e internetit, që i kushtohet vizitës së Benediktit XVI në Britaninë e Madhe, kryetari i Konferencës Ipeshkvnore të Anglisë e të Uellsit, imzot Vinsent Nikols nënvizon se është hera e parë që një Papë ftohet të vizitojë Mbretërinë e Bashkuar nga vetë mbretëresha: “Ky – pohon imzot Nikols – është një moment thellësisht domethë-

nës për krejt vendin e natyrisht për bashkësinë katolike”. Shpresoj, shton ai, që do të tregojë se bashkësia katolike është me të vërtetë e aftë të kontribuojë në mirëqenien e kombit. Katolikët mund ta mbështesin këtë mision duke qenë të pranishëm e duke u lutur me Papën, por edhe duke shfaqur gëzimin, që vjen nga feja, në mënyrën me të cilën i bëjnë gjërat. Për të përgatitur udhëtimin, nga ana e qeverisë britanike, është caktuar ministri Xhim Marfi, i cili, gjatë konferencës për shtyp, vuri theksin në rëndësinë e ndikimit që ka Selia e Shenjtë dhe Papa në fusha të ndryshme ndërkombëtare dhe në dialogun ndërmjet feve. Edhe Papa Gjon Pali II pati shkuar në Britaninë e Madhe në vitin 1982, por jo në vizitë shtetërore. Po atë vit, u vendosën marrëdhëniet e plota diplomatike ndërmjet Vatikanit dhe Mbretërisë së Bashkuar.

(Përgatiti: Don Pal TUNAJ)




# Judë Iskarioti dhe Matia

■ PËRGATITI:  
Don Marjan MARKU

Nëse dëshirojmë t'i përmendim 12 apostujt, të cilët i kishte zgjedhur vetë Jezu Krishti gjatë jetës së tij tokësore, s'kemi se si të mos e përmendim edhe apostullin e fundit, të cilin e thirri Jezusi e ky ishte Judë Iskarioti. Së bashku me të dëshirojmë që ta marrim edhe pasardhësin e tij, i cili ishte i zgjedhur prej apostujve, e ky ishte Matia.

Në mesin e të krishterëve, sot, kur e përmendim emrin Judë, nënkupton një reaksion instinktiv të kundërshtimit dhe gjykitimit. Domethënia e emrit "Iskariot" është mjaft diskutabil, por shumica e shpjegojnë me vendin e prejardhjes së Judës "Njeriu nga Kerijot" dhe kështu tregon vendin e prejardhjes së tij, i cili gjendet afër Hebronit dhe cekët dy herë në Shkrimin Shenjt (Krah. Jos 15,25; Am 2,2). Të tjerët e interpretojnë si variant të fjalës »sicarius«, që domethënë: vrasës i pabesë, i cili luante si një luftëtar çete, i cili ishte i armatosur me një kam dhe në gjuhën latine është quajtur »sica«. Disa e shpjegojnë nga gjuha hebraishte dhe arameishte dhe ka domethënien e atij që ka për qëllim për ta tradhtuar. Kjo domethënie gjendet dy herë në Ungjillin e katërt dhe atë pas dëshimit të fesë së Pjetrit (Krah. Gjn 6,71) dhe pastaj gjatë përrurimi në Betani (Krah. Gjn 12,4). Vendet tjera tregojnë për planifikimin e tradhtisë, kur thuhet: »tradhtari i tij«; gjatë darkës së fundit, pas shpalljes së tradhtisë (Krah. Mt 26,25) dhe pastaj gjatë burgimit të Jezusit (Krah. Mt 26,46-48; Gjn 18,2,5). Po ashtu edhe në listën e 12 apostujve kemi edhe paralajmërimin e veprës së Judës: »Juda Iskariot, i cili edhe e tradhtoj«, thotë Marku (3,19); ndërsa tek Mateu (10,4) dhe Luka (6,16) gjendet një formulim i ngjashëm. Tradhtia si e tillë është zhvilluar në dy momente: në rend të parë në planifikim, kur Juda ra në dakord me kryepriestërinjtë për ta dorëzuar për 30 sikla të argjendta (Krah. Mt 26,14-16), dhe në rend të dytë gjatë realizimit të veprës, kur ai e puthi mësuesin e tij në kopshtin e Gjetsemanit (Krah. Mt 26,46-50). Duke i lënë të gjitha këto anash mund të themi se Ungjilltarët Judën e cekin se ishte njëri ndër apostujt dhe se gjendet në listën e njërit nga të dymbëdhjetët (Krah. Mt 26,14. 47; Mk 14,10. 20; Lk 22, 3; Gjn 6,71). Jezusi, kur bisedonte me apostujt, dy herë tha: »njëri prej jush do të më tradhtoj«, duke menduar në Judën. (Mt 26,21; Mk 14,18; Gjn 6,70;13,21).



“Në planin plotësisht të fshehët të shëlbimit, Hyji e mori veprën e Judës si mundësi për dorëzimin e plotë të birit për shëlbimin e botës.”

Dhe Pjetri më vonë do të thotë për Judën: »Ai ishte vërtet nga numri ynë dhe kishte pjesë në këtë shërbesë« (Vap 1,17).

Pra, kemi të bëjmë me një person, i cili gjendet në rrethin e atyre, të cilët vetë Jezu Krishti, i kishte zgjedhur si përcjellës dhe bashkëpunëtorë të tij. Në aspektin e tundimit, sipas asaj që ka ndodhur, mund të shtrohen dy pyetje. Pyetja e parë është, të cilën ndoshta kishim për ta shtruar edhe ne, përse Jezusi e ka zgjedhur këtë njeri dhe ia ka dhuruar besimin e apostullit? Edhe pse Juda ishte përgjegjës për kasën e përbashkët të grupit (Krah. Gjn 12,6b; 13,29a), ai u karakterizua edhe si »vjedhës« (Gjn 12,6a). Fshtësia e zgjedhjes për apostull mbetet e pa zgjidhur, por edhe gjykimi i rënd i Jezusit që e thotë për të: »Vaj për atë njeri që po e tradhton birin e njeriut! Më mirë do të kishte qenë për të mos kishte lindur aspak« (Mt 26,24). Edhe më tepër rritet fshtësia e fatit të tij të përgjeshëm, duke e parë pendimin dhe përfundimin e tij. »Atëherë Juda – ai që e tradh-

toi, kur pa se e dënuan Jezusin, i brejtur nga ndërgjegjja, ua ktheu kryepriestërinjtë e pleqve të popullit tridhjetë siklat e argjendta e tha: Mekatova që dorëzova gjakun e pafaj« (Mt 27,3-4). Edhe pse pastaj shkoi për t'u varë në lak (Krah. Mt 27,5), ne nuk mund ta masim veprën e tij e mos të shpresojmë në mëshirën e pafund të Hyjit.

Një arsye tjetër: Përse Juda e ka tradhtuar Jezusin? Kjo pyetje krijon hipoteza të ndryshme. Disa e shpjegojnë veprimin e tij për shkak të parave. Të tjerët e shpjegojnë në aspektin mesianik: Juda ka qenë i dëshpëruar kur e ka parë se në planin e Jezuit nuk ishte çlirimi i vendit të tij. Ndërsa nga tekstet e Ungjillit na paraqitet një aspekt tjetër. Gjoni thotë qartë: »Djali ia kishte mbushur mendjen Judës, birit të Simon Iskariotit, ta tradhtoj« (Gjn 13,2). Në mënyrë të ngjashme shkruan edhe Luka: »Djali hyri në Judën që quhet Iskariot, i cili ishte një nga të Dymbëdhjetët« (Lk 22,3). Në këtë mënyrë mund të shihet motivacioni historik dhe mund të

“Përse Juda e ka tradhtuar Jezusin? Kjo pyetje krijon hipoteza të ndryshme. Disa e shpjegojnë veprimin e tij për shkak të parave. Të tjerët e shpjegojnë në aspektin mesianik: Juda ka qenë i dëshpëruar kur e ka parë se në planin e Jezuit nuk ishte çlirimi i vendit të tij. Ndërsa nga tekstet e Ungjillit na paraqitet një aspekt tjetër. Gjoni thotë qartë: »Djali ia kishte mbushur mendjen Judës, birit të Simon Iskariotit, ta tradhtoj« (Gjn 13,2).”

shpjegohet ndodhia në bazën e përgjegjësisë personale të Judës, i cili dorëzohet në tundimin e djallit. Në çdo mënyrë tradhtia e Judës mbetet një fshtësi. Jezusi atë e ka dashur si mik (Krah. Mt 26,50); dhe e ka thirrur për të ecur në rrugën e lumturive, askush nuk e përdorë dhunën në dëshirën e njeriut, duke mos e ruajtur nga tundimi i djallit dhe duke respektuar lirinë njerëzore.

Mundësitë për mashtrim në veprën në zemrën e njeriut janë të shumta. Rruga e vetme për të ikur prej tyre, qëndron jo vetëm në shikimin individual dhe autonom të gjërave, por në kundërshtim të përhershëm duke qëndruar në anën e Jezusit dhe duke e pranuar mësimin e tij. Ne duhet që të tentojmë ditë për ditë të qëndrojmë në bashkim të plotë me të. Ta përkujtojmë Pjetrin, i cili dëshironte ta qortonte Jezusin nga paralajmërimi i vdekjes së tij, se çka i tha Jezusi: »Mu hiq sysh, he djall, se nuk i ke ndër mend punët e Hyjit, por punët e njerëzve« (Mk 8,32-33)! Pas këtij rasti Pjetri fitoi faljen dhe hirin. Po ashtu edhe Juda u pendua, por pendimi i tij u shndërrua në dëshpërim dhe kjo e çoi në vetëshkatërrim. Ky rast duhet të jetë edhe për ne një mësim duke na mësuar që ti mbajmë sytë e hapur, siç thotë Shën Benedikti në fund të kaptinës së katërt të rregullave të tija: Dhe në mëshirën e Hyjit kurrë mos u dëshpëroni. Me të vërtetë »Hyji është më i madh se zemra jonë«, pohon Shën Gjoni (1 Joh 3,20). Ne përherë duhet t'i kemi dy gjëra para syve tanë. E para: Jezusi e respekton lirinë tonë. E dyta, Jezusi pret gatishmërinë tonë që të pendohemi dhe të kthehemi, sepse ai është i pasur me mëshirë dhe me falje.

Nëse shikojmë në rolin negativ, të cilin e ka luajtur Juda, ne kësaj përmes Hyjit duhet që t'ia japim kuptimin e lartë. Tradhtia e tij Jezusin e çoi në vdekje, në një kryqëzim të tmerrshëm, por kjo u shndërrua në dashurinë e shëlbimit dhe në dhurimin e vetvetes. (Krah. Gal 2,20; Ef 5,2.25). Fjala »tradhti« është përkthim i një fjale greke, e cila domethënë »kushtim, flijim, dhurim«. Nganjëherë subjekti i tij është vetë Hyji: Ai, i cili për dashurinë e Jezusit dha gjithçka për ne (Krah. Rom 8,32). Në planin plotësisht të fshehët të shëlbimit, Hyji e mori veprën e Judës si mundësi për dorëzimin e plotë të birit për shëlbimin e botës.

Për fund, dëshirojmë që ta përkujtojmë edhe atë që pas Pashkëve, u zgjodh në vend të tradhtarit. Në kishën e Jerusalemit ishin paraqitur dy njerëz para bashkësisë: Jozefi, i ashtuquajtur Barsabë me mbiemrin Just dhe Matia. (Vap 1,23). »Atëherë qitën short e shorti i ra Matisë, e kështu u radhit në numrin e të Njëmbëdhjetë apostujve« (Vap 1,26). Për të nuk dimë asgjë tjetër, përveç se gjatë tërë jetës së tij ishte dëshmitar i Jezusit (Krah. Vap 1,21-22) duke mbetur besnikë deri në fund. Në besnikërinë e tij i erdhi edhe thirrja e Hyjit për ta marrë vendin e Judës dhe kështu për ta barazuar tradhtinë e tij. Këtu mund ta fitojmë dhe një mësim të fundit: Edhe pse në Kishë nuk mungojnë të krishterët e padenjë dhe tradhtarë, secili prej nesh është i thirrur që të krijojë një bashkëpeshim, përmes dëshmisë sonë të qartë për Jezus Krishtin, Zotin dhe shëlbuesin tonë. Amen.




# Letra e Atit të Shenjtë Benediktit XVI në fillimin e vitit meshtarak me rastin e 150-vjetorit të “Dies Natalis” të Shën Gjon Maria Vianney

*Të dashur vëllezër në meshtari,*

në festën e ardhshme të Zemrës së Shenjtë të Krishtit, e premte 19 qershor 2009 – ditë tradicionale e kushtuar lutjes për shenjtërimin e klerit, kam menduar të inicioj zyrtarisht një “vit meshtarak” në rastin 150-vjetorit të “dies natalis” të Gjon Maria Vianney, pajtorin e të gjithë famullitarëve të botës. Një vit i tillë, që dëshiron të kontribuojë në promovimin e angazhimit të ripërtëritjes të brendshme të të gjithë meshtarëve për një dëshmi më të fortë ungjillore në botën e sotme, do të përmbillet në po të njëjtin solemnit të 2010-s. “Meshtaria është dashuria e Zemrës së Jezusit”, theksonte famullitari i Arsit. Kjo shprehje na mundëson para së gjithash për të evokuar me butësi e mirënjohje dhuratën e paçmueshme që meshtaria ka për Kishën dhe për njerëzimin. Në këtë moment mendoj për të gjithë ata meshtarë, që ditë për ditë u ofrojnë besimtarëve të krishterë dhe botës mbarë propozimin e përditshëm dhe të përvuajtur të fjalëve e të gjesteve të Jezu Krishtit, duke u përpjekur t’i përngjajnë atij me mendime, me vullnet, me ndjenja e me stilin e krejt ekzistencës së vet. Si mos të konsiderojmë mundin e tyre apostolik, shërbimin e tyre të palodhshëm e të fshehur, dhe bamirësinë e tyre universale? E çka të themi edhe për besnikërinë shumë të guximshme të shumë meshtarëve, edhe pse me shumë vështirësi dhe moskup-time, i qëndrojnë besnikë thirrjes së tyre: asaj thirrje që të jenë “miqtë e Krishtit”, nga Ai posaçërisht të thirrur, të zgjedhur dhe të dërguar?

Edhe unë vet mbaj në zemrën time kujtimin famullitarit të parë, afër të cilit e ushtrova detyrën si meshtar i ri: ai më dha shembullin e një përkushtimi pa rezervë në shërbimin pastoral, deri sa rrezikohej për vdekje, ndërsa shkonte për të ndarë sakramentin e vajimit një të sëmuri rëndë. Më kthehen prapë në kujtimet e mia shumë vëllezër që i kam takuar dhe i takoj gjatë vizitave të mia baritore në vendet e ndryshme, të cilët i gjej të angazhuar me shumë bujari në shërbimin e tyre të përditshëm meshtarak. Por shprehja e përdorur prej famullitarit të Arsit evokon edhe shporimin e Zemrës së Krishtit dhe kurorën me ferra që ai e mbante. Mendimi, pra, u shkon pa mëdyshje, shumë situatave që kaplohen nga vuajtjet, në të cilat gjenden shumë meshtarë, qoftë sepse marrin pjesë



në përvojën njerëzore të vuajtjes, në shumë mënyra të manifestimit të saj, qoftë për arsye të moskup-timit të destinuesve të tyre dhe të shërbimit që ata e bëjnë: si mos të kujtojmë shumë meshtarë të prekur në dinjitetin e tyre, të penguar në misionin e tyre, e shpeshherë edhe të persekutuar deri në dëshminë më supreme me gjak?

Janë mjerisht, edhe situata, jo shumë të studiuar, ku vetë kisha vuan për pabesnikërinë e shërbëtorëve të vet. Dhe bota mjerisht është gati të gjejë arsyen e shkandullit dhe të refuzimit. Ajo çka mundet maksimalisht të ndihmojë në këtë rast Kishën, nuk është evidentimi i dobësive të ministrave të saj, sa çështje një ripërtëritje e ndërgjegjes në madhësinë e hirit të Zotit, të konkretizuar në disa Bari bujarë, rregulltarë të flaktë për dashuri ndaj Hyjit, drejtues shpirtërorë të ndriçuar dhe të durueshëm. Në këtë drejtim, shembulli dhe mësimi i Shën Gjon Maria Vianney mund të na dhurojë një pikë referimi të rëndësishëm: famullitari i Arsit ishte shumë i përvuajtur, por i vetëdijshëm si meshtar, që ishte një dhuratë tepër e çmueshme për popullin: “një bari i mirë, një bari sipas zemrës hyjnore, është thesari më i madh që Hyji mund t’ia dhurojë një famullie e është njëra prej dhuratave më të çmueshme të mëshirës hyjnore”. Fliste për meshtarinë sikur dëshironte të vinte në pah paafësinë për t’ia besuar një detyrë kaq të madhe një krijese njerëzore: “oh, sa i madh është meshtari!”...po ta kuptonte do të vdiste...Zoti e dëgjon: ai i shpreh dy fjalë dhe Zoti ynë zbret nga

qielli mbas zërit të tij e mbyllet në një hostje të vogël”. E duke ia shpjeguar besimtarëve të vet rëndësinë e sakramenteve thotë: “nëse e tërhiqim sakramentin e urdhrin të shenjtë, ne nuk do ta kishim Zotin. Kush e ka vërë atje në tabërnakull? Meshtari. Kush e ka pranuar shpirtin tuaj në fillim e jetës suaj? Meshtari. Kush e ushqen për t’i dhënë forcë në realizimin e shtegtit të tij? Meshtari. Kush do ta përgatit për takimin e fundit, duke e larë për herë të fundit në gjakun e Jezu Krishtit? Meshtari dhe gjithmonë meshtari. E nëse shpirti vdes (për shkak të mëkatit) kush do ta ringjallë, kush do t’ia dhurojë qetësinë dhe pagën? Dhe atëherë meshtari... pas Zotit meshtari është gjithçka!... edhe ai vetë nuk do të kuptojë vetveten deri atëherë kur të arrijë në qiell”. Këto pohime, të lindura prej famullitarit të shenjtë të Arsit, mund të duken si të tepruara. Megjithatë në to zbulohet nderimi i lartë që ai kishte për sakramentin e urdhrin të shenjtë të meshtarisë. Ishte i përfshirë nga një ndjenjë e madhe e përgjegjësisë: “po ta kuptonim vërtet se çka është meshtari mbi tokë, do të vdisnim: jo prej frikës, por prej dashurisë...Pa meshtarin vdekja dhe mundimet e Zotit tonë Jezu Krishtit nuk do të shërbenin asgjë. Është meshtari që e vazhdon veprën e shëlbimit mbi tokë...Çka do të na shërbente një shtëpi përplot me ari, po mos të ishte ndo kush që të na hapë derën. Meshtari posedon çelësat e thesareve qiellore: është ai që e hap derën; ai është ekonomi i Hyjit; administrator i të mirave të tij...Leni një famulli pa meshtar vetëm 20 vjet,

aty do të adhurohen shtazët, prifti nuk është prift për vetë, por për ju”.

Kishte arritur në Ars, në një fshat prej 230 frymë, i paralajmëruar prej ipeshkvit që do të kishte gjetur një situatë fetare jo aq të lakmueshme: “nuk ka shumë dashuri hyjnore në këtë famulli, po ju jeni ai që atë do ta dërgoni”. Sipas kësaj, ishte plotësisht i vetëdijshëm që i duhej të shkonte për të mishëruar praninë e Krishtit, duke e dëshmuar dashurinë shpëtimprurëse: ‘O Hyji im, ma dhuroni kthimin e famullisë sime; pranoj të vuaj krejt atë që dëshironi gjatë tërë jetës sime!’, dhe kjo që lutje e inicimit të misionit të tij. Pra kthimit të famullisë së vet; famullitari i Arsit iu përkushtua me të gjitha energjitë e tij, duke e vënë si qëllim kryesor të mendimit të tij formimin e krishterë të popullit që atij iu besua. Të dashur vëllezër në meshtari, t’i kërkojmë Zotit Jezus hirin për të pasur mundësi të kuptojmë edhe ne metodën baritore të Shën Gjon Maria Vianney! Ajo që menjëherë duhet mësuar, është padyshim identifikimi i plotë i tij me shërbesën. Në Jezusin, Personi dhe Misioni përputhen: krejt vepra e tij shpëtimprurëse ishte dhe është shprehje e “unit-prej-të-biri”, që prej amshimit qëndron pranë Atit në qëndrimin e dashurisë dhe të nënshtrimit të vullnetit të tij. Me të njëjtën analogji edhe meshtari duhet t’i përshtatet këtij identifikimi. Nuk kemi të bëjmë këtu me harresën, ku efikasiteti substancial i shërbimit qëndron i pavarur prej shenjtërisë së meshtarit; por nuk guxohet të lihet anash as fryti i prodhuar prej takimit në mes të

shenjtërisë objektive të shërbesës dhe asaj subjektive të shërbëtorit. Famullitari i Arsit menjëherë e filloi këtë punë të mirë të harmonizimit të jetës së tij si shërbëtor dhe shenjtërisë së shërbesës që atij i ishte besuar, duke e theksuar që “jetonte” në kishën e tij famullitare: “si arriti në këtë vend, ai zgjodhi kishën si shtëpi të vetën... Hynte në kishë para agimit nuk dilte vetëm pas engjëllit Tenzot në mbrëmje. Vetëm atje duhet ta kërkonte kur kishin nevojë për të”, lexohet në biografinë e parë për të.

Teprimi i shkrimtarit të devotshëm nuk duhet ta lë anash faktin së famullitari i Arsit dinte edhe të “jetonte” aktivisht në mbarë territorin e famullisë së tij: i vizitonte sistematikisht të sëmurët dhe familjet; organizonte misionet popullore e festat e pajtorit, grumbullonte dhe administronte para për veprat e tij të bamirësisë, e zbukuronte kishën e tij dhe e pasuronte me mobile të shenjta; kujdesej edhe për bonjakët e “Provanisë” e të edukatorëve të saj; interesohet për arsimimin e fëmijëve; themelonte shoqata dhe fronte laikë për bashkëpunim.

Shembulli i tij më nxit t’i theksoj edhe më tepër fushat e bashkëpunimit e që është e detyrueshme të hapen edhe për besimtarët laikë, me të cilët meshtarët e formojnë po të njëjtin popull meshtarak dhe në mesin e të cilëve, me anë të shërbesës meshtarake, gjenden “për ta dërguar në bashkimin e dashurisë, duke e dashur njëri-tjetrin me dashuri vëllazërore, duke e pranuar njëri-tjetrin në diferencë (Rom 12,10)”. Është për ta kujtuar, në këtë kontekst, ftësen shumë të dashur që na e bën Koncili i Dytë i Vatikanit, duke i inkurajuar meshtarët “që të njohin dhe të promovojnë me singertet dinjitetin e laikut, duke mos e lënë anash gjithashtu edhe rolin specifik që ata kanë në fushën e misionit të Kishës...Le të jenë gjithnjë të gatshëm t’i dëgjojnë mendimet e laikëve, duke konsideruar me interesim vëllazëror aspiratat e tyre dhe duke marrë parasysh edhe përvojat e tyre e kompetencat në fushat e ndryshme të aktiviteteve humane, në mënyrë që së bashku t’i njohin shenjat e kohës”.

Besimtarëve të vet famullitari i Arsit u mësonte në veçanti me dëshminë e jetës. Prej shembullit të tij besimtarët mësonin lutjen, duke u ndalur me dëshirë për një vizitë, qoftë ajo edhe e shkurtër, para Jezusit Eukaristik. “Nuk ka nevojë që të flitet shumë për t’u lutur mirë”- u thoshte atyre famullitari – “Dihet që Je-



**“Në këtë drejtim, shembulli dhe mësimi i Shën Gjon Maria Vianney mund të na dhurojnë një pikë referimi të rëndësishëm: famullitari i Arsit ishte shumë i përvuajtur, por i vetëdijshëm si meshtar, që ishte një dhuratë tepër e çmueshme për popullin: “një bari i mirë, një bari sipas zemrës hyjnore, është thesari më i madh që Hyji mund t’ia dhurojë një famullie e është njëra prej dhuratave më të çmueshme të mëshirës hyjnore.”**

zusi është aty, në Tabernakullin e shenjtë: t’ia hapim zemrën tonë, le të gëzohemi për praninë e tij. Kjo është lutja më e mirë”. Thekson: “ejani në kungim, vëllezërit e mi, ejani tek Jezusi. Ejani e jetoni prej Tij për të pasur mundësi të jetoni me Të. “Është e vërtetë që ndoshta nuk jeni të denjë, por keni shumë nevojë!”. Një edukim i tillë ndaj pranisë Eukaristike dhe ndaj Kungimit, kishte një efikasitet të veçantë, sidomos kur e shihnin atë në kremtimin e meshës. Kush ishte i pranishëm, si zakonisht thekson: “nuk ishte e mundur të gjendej diku një figurë që më mirë e shprehte adhurimin...E sodiste hostjen me shumë dashuri”. “Të gjitha veprat e bashkuara nuk janë të barabarta me meshën, sepse ato janë vepra njerëzore, ndërsa mesha është vepër hyjnore”. Ishte i bindur se nga mesha varej krejt zelli i një meshtari: “shkaku i rënies së një meshtari është pikërisht moskujdesi fare për meshën! O Zoti im, sa është e mjerueshme për një meshtar kur kremton, sikur të bënte diçka të zakonshme!”. Tashmë e kishte marrë zakon gjithmonë, që, duke kremtuar, ofronte edhe jetën e vet në flijim: “Sa mirë është që një meshtar t’i përkushtohet Zotit për çdo mëngjes”.

Ky personalizim me flijimin e Kryqit, e dërgonte – me një lëvizje të brendshme, interiore – prej altarit në rrëfyestore. Meshtarët kurrë nuk duhet të pajtohen me rrëfyestoret e tyre të zbrazëta edhe në konstatimin e një qëndrimi të kundërt të besimtarëve me këtë sakrament. Në kohën e famullitarit të Arsit, në Francë, rrëfimi nuk ishte as më i lehtë, as më i frekuentuar se sa në ditët tona, meqenëse fryma revolucionare ia kishte zënë frymën edhe zbatimit fetar. Por ai pa ndërprerje u përpoq që me anë të predikimit dhe këshillave, t’ua zbulonte besimtarëve të vet bukurinë e pendimit sakramental, duke e paraqitur sikur një nevojë intime e Pranisë Eukaristike. Ai diti ta zgjidhte një çështje pothuaj të pazgjidhshme. Me praninë e gjatë të tij në Kishë, para Tabernakullit, bëri që shumë besimtarë ta emitonin, duke u ndalur në vizitë tek Jezusi, dhe duke qenë, në të njëjtën kohë, të sigurt ta gjenin aty edhe famullitarin e tyre, i gatshëm në dëgjim dhe në falje. Në vazhdim ishte gjithnjë në rritje masa e të penduarve, të ardhur nga e tërë Franca, për ta mbajtur (në rrëfyesatore) famullitarin deri në 16 orë në ditë. Thuhej në atë kohë që Arsi ishte transformuar në “spitalin e madh të shpirtave”. “Hiri që ai mbante (për kthimin



e mëkatarëve) ishte po aq i fortë, sepse shkonte drejt kërkimit të tyre, pa u dhënë atyre mundësinë për të ikur!”, thoshte biografi i parë. Famullitari i Arsit nuk mendonte ndryshe kur thekson: “nuk është mëkatori që kthehet te Zoti për të kërkuar falje, por është vetë Zoti që shkon vrap pas tij për ta kthyer tek Ai”. “Ky shpëtimtar i mirë është kështu përplot me dashuri që na kërkon gjithkund”.

Të gjithë ne meshtarët duhet për ta ndërje që na takojnë personalisht ato fjalë që ai i vende në gojën e Krishtit: “i ngarkoj shërbëtorët e mi që t’iu shpallin mëkatarëve që janë gjithnjë të gatshëm t’i pranojnë, dhe që mëshira ime është e pakufishme”.

Nga famullitari i Arsit, ne meshtarët mund të mësojmë jo vetëm një besim të pafund ndaj sakramentit të rrëfimit, që na shtyn ta vendosim në thelb të preokupimeve tona pastorale, por edhe metodën e “dialogut të shpëtimit”, që ne të duhet ta zhvillojmë. Famullitari i Arsit e kishte një metodologji të veçantë ndaj çdo pendestari. Kush hynte në rrëfyestoren e tij, i tërhequr nga një përvojë intime dhe të përvuajtur të faljes së Zotit, gjen në të inkurajim të zhytet në “valët e mëshirës hyjnore” që përfshijnë gjithçka në përplasjen e saj. E nëse ndokush ishte i mbërthyer dhe i mërzhitur në mendimet e tij, për dobësitë e veta dhe paqëndrueshmërinë e tij,

në frikë ndaj rënies të ardhshme në mëkate, famullitari i Arsit ia zbulonte fshehtësinë e Hyjit me një shprehje të prekshme dhe të bukur: “Zoti i mirë di gjithçka”. Para se ju të rrëfëheni, ai e di se do të mëkatoni, por megjithatë ai ju fal. Sa është e madhe dashuria e Zotit që na shtyn deri aty, sa ta harrojmë vullnetarisht ardhmërinë, vetëm që të na fal!” Atij që e akuzonte vetveten në mënyrë të butë dhe gati në mënyrë indifferente, ia ofronte nëpërmjet lotëve të tij, evidencën shumë serioze, dhe sa ai qëndrim ishte “me plotë dashuri”: “qaj sepse ju nuk qani” thoshte. „Nëse Zoti nuk do të ishte i mirë! Por është i mirë! A duhet të jemi barbarë me sjellje ndaj një Ati kështu të mirë”. Bënte që të linte pendimi në zemrat e pendestarëve duke i detyruar të shikonë në sytë e tyre, vuajtjet e Zotit për mëkatet gati të “mishëruar” në fytyrën e meshtarit që i rrëfente. Ata që i paraqiteshin të vullnetshëm dhe të aftë për një jetë më të thellë shpirtërore, haptë thellësinë e dashurisë duke i shtyrë drejtë bukurisë që të kishin mundësi të jetojnë të bashkuar me Zotin dhe në praninë e tij: “gjithçka nën shikim e Zotit, gjithçka me Zotin, gjithçka për t’i pëlqyer Hyjit...sa është e bukur!” Dhe i mësonte ata që të luten: “Hyji im, ma dhuro hirin të dua shumë, aq sa është e mundur që unë të të dua”.

Famullitari i Arsit në kohën e

tij ka ditur ta ndërrojë zemrën dhe jetën e shumë personave, sepse ka arritur që t’i bëjë të aftë ta pranojnë dashurinë e mëshirshme të Zotit. Ndihet nevoja edhe në kohën tonë për një shpallje të tillë dhe për një dëshmi të tillë për të vërtetën e dashurisë: Deus Caritas est (1 Gjn 4, 8). Me Fjalën dhe me sakramentet e Jezu Krishtit Gjon Maria Vianney ka ditur ta ndërtonte popullin e tij, edhe pse shpesh herë ndalej në ndjenjën e paaftësisë së tij personale, deri sa dëshironte shpeshherë të largohej nga përgjegjësia e shërbesës së famullitarit, ndaj së cilës ndihej i paftë. Megjithatë, me një dëgjueshmëri të pasqorë qëndroi në vendin e vet, sepse e ndizte zelli apostolik për shpëtimin e shpirtave. Mendohej t’i përshkatej krejtësisht thirrjes së tij dhe misionit, nëpërmjet një askeze të ashpër: “reziku më i madhi për ne famullitarët është që shpirtin shpeshherë e kaplon përtacia”, dhe me këtë nënkuptonte një rrezik në veprimtarinë e bariut në gjendje të mëkatit apo të indiferencës, në të cilat jetojnë shumë “dele”. Ai e mbante nën kontroll trupin me vigjilime e agjërimë, për të parandaluar që t’i vende përballë rezistencë shpirtit të tij meshtarak. Dhe nuk ndalej në mendime ndaj vetes për të mirën e shpirtave që i ishin besuar dhe për të kontribuar në shlyerjen e shumë mëkateve të dëgjua në rrëfyestore. I shpjegonte një bashkëvëllait meshtar: “do ta them cili është recepti im: ju jap mëkatarëve një pendesë të vogël dhe pjesën tjetër e bëj unë në vendin e tyre”. Përveç pendesave konkrete që i bënte famullitari i Arsit, është e vlefshme për të gjithë thelbi i mësimi të tij: shpirtat i kushtojnë gjakut të Krishtit dhe meshtari nuk mund t’i përkushtohet shpëtimit të tyre, nëse dëbon pjesëmarrjen personale në “çmimin shumë të naltë” të shëlbimit.

Në botën e sotme, ashtu sikur në kohët e vështira të famullitarit të Arsit, është e nevojshme që meshtarët në jetën dhe veprimtarinë e tyre të dallohen për një dëshmi të fortë ungjillore. Me të drejtë ka thënë Papa Pali i VI: „njeriu bashkëkohor i dëgjon më me dëshirë dëshmitarët se sa mësuesit, nëse i dëgjon mësuesit, e bën këtë për shkak të dëshmitarëve”.

(Vazhdimi i letrës do të botohet në numrin e ardhshëm)

## Fabula e rrëfimit

Të krishterët, katolikët, janë të detyruar, që së paku një herë në vit të rrëfëhen. E kjo mos ndryshe, bile në Javën e Madhe, para Pashkëve.

Për ta përmbushur këtë detyrim, por para se gjithash, edhe për ta pasur ndërgjegjen të qetë dhe barrën shpirtërore më të lehtë, kështu u morën vesh mes veti një ditë Kola, Gjergji dhe Pali, që të shkojnë në kishë për ta kryer obligimin e vet, që i mundonte sa e sa kohë.

Në kishë kishte ca besimtarë, por jo edhe ndonjë rrëfyestar. Ata u lutën pak sa për “syfaqe”, dhe dolën nga kisha për të shkuar të zyra e famullitarit, athua mos kishte qëlluar aty famullitari, ose s’do të prishte punë edhe ndonjë prift tjetër.

Ashtu të përvuajtur, “si ata më”, trokitën në derën e shtëpisë së famullisë. Pas pak çastesh doli një motër te dera për të parë se kush po trokiste aq bindshëm n’atë kohë dhe pastaj për ta hapur derën.

Motra lëshoi një sy vrimës derës dhe dukeshin tre burra rreth katërdhjetë e pesëdhjetë vjeç. Ata ishin mu të asaj famullie dhe motra i njihte për burra të ndershëm dhe shumë të mirë. Meqë ishte ashtu, ajo e hapi derën dhe u tha: “O, mirë se vini, Kolë, urdhëroni e hyni brenda!”

Kola ia priti, duke thënë: “Jo, motër, nuk po kemi edhe aq kohë. Ne kemi ardhur për një qëllim tjetër.”

“Ç’është, or Kolë, ç’është mirë keni, na thoni pra?” vazhdoi motra.

Pali pëshpëriti me një zë tepër të ultë dhe tha: «Po ne, motër, kemi ardhur që të rrëfëhemi. Tani është koha e rrëfimeve, po a ka ndonjë meshtar këtu?»

Motra iu përgjigj: “Po, Pal, si jo. Tre janë, e jo vetëm një.”

“Shumë mirë”, klithi Gjergji më zë pak sa më të lartë se Pali.

“Oh sa mirë, tamam qenkan tre, sepse ka tri vite që nuk jam rrëfyer!”

Kola, kokulur e me një ton mëzi dëgjohej iu dretua Palit e pastaj Gjergjit: “Mirë boll për ty, Pal; ti kërrove një prift për një vit që nuk je rrëfyer. Ata qenkan tre, që edhe për ty, Gjergj, po bëhet mirë, se po e kryen obligimin tënd.”

Kola vazhdoi bisedën e vet edhe më: “Po ç’është unë i shkretë se? A di që, 12 vjet ka që s’jam rrëfyer!”

Motra tha: “Uh, i gjori Kolë, ti paske sharruar shumë thellë!”

“Po ty, vështirë e paskan të nxjerrin edhe meshtari me të 12 apostujt!” vazhdoi motra.

Kola u përgjigj më zë pak sa të dridhur: “Mirë de, pra! Atëherë po pres deri në vjeshtën e ardhshme e do të shkoj në Prishtinë kur do të çohet Mesha pontifikale për të parën herë në Katedralen e Nënës Tereze. Dhashtë Zoti, e atëherë do të mblidhen edhe më shumë se dymbëdhjetë meshtarë dhe disa ipeshkvij dhe ashtu të bashkuar pranë altarit në Katedralen e së Lumës Nënës Tereze, ndoshta, do të kenë mëshirë dhe do t’mi falnin mëkatet për 13 vitet e kaluara!”

(Engjell Kengji)



# Vizita Baritore e Ipeshkvi

■ SHKRUAN:  
Don Albert JAKAJ

Nëpërmes vizitës pastorale apo baritore Imzot Dodë Gjergji, Ipeshkvi ynë, dëshiron të njihet për së afërmi me meshtarët e me motrat rregulltare, të cilat jetojnë dhe veprojnë në famulli, si dhe me të gjitha strukturat tjera, me përqendrim në këto lëmi:

- Gjendja e bashkësisë famullitare dhe marrëdhënia mes meshtarit dhe grigjës, popullit, kuptohet, në rolin e prijësit dhe dëshmitarit të Ungjillit, si profet dhe ungjillëzues.
- Bashkëpunimi mes meshtarit – famullitarit dhe motrave, Këshillit të famullisë, si dhe takimi me të zotët e shtëpisë, me korin e kishës, rininë, grupet katekistike, grupet apo lëvizjet e ndryshme laike. Fushëveprimi i tyre, grupet e punës, synimet, përvojat, propozimet...
- Gjatë vizitës baritore Ipeshkvi do të jetë në shërbim për ndarjen e sakramenteve dhe sakramentoreve, si dhe për vizitë të të sëmureve në dy familje: te ndonjë familje me të moshuar dhe të sëmure dhe te një familje tjetër me ndonjë handikap, sipas zgjedhjes së famullitarit.
- Po ashtu, do të ishte mirë të organizohet takimi edhe me të varfërit e famullisë, si dhe te një familje e merituar, e njohur dhe e pranuar për të mirë, për drekë apo darkë në famulli, apo edhe në familjen e tyre.
- Takimi i Ipeshkvit me strukturat tjera fetare që janë të pranishme në famulli, si dhe institucionet shkollore, shëndetësore, pushteti lokal...

Koha e vizitës baritore: marsi dhe prilli 2010 për pjesën e Gjakovës, me fillim të premtën dhe përfundim të dielën. Të dielën pasdite fillon vizita në ndonjë famulli tjetër.

Radhitja e vizitës do të jetë: Doblibare, Beci, Novosella, Pjetroshani, Bishtazhina dhe Gjakova.

## Vizita baritore në famullinë e Shën Mëhillit në Doblibare

Në kuadrin e vizitës baritore që ipeshkvi ynë, Imzot Dodë Gjergji, ka ndërmarrë në Dioqezën tonë, arriti që prej datës 12-14 mars, të jetë në famullinë e Shën Mëhillit në Doblibare, ku famullitar është Don Kolë Thaqi dhe ku shërbejnë motrat Bijat e Dashurisë Hyjnore. Pranimi i Ipeshkvit filloi në oborrin e Kishës, ku e kanë pritur fëmijët, të rinjtë e të moshuarit e famullisë. Fjalën përshëndetëse në emër të pranishmëve e bëri drejtori i Shkollës Fillore në Doblibare, duke i uruar mirëseardhjen, i cili ndër të tjera tha: “Për ne sot është një ditë e gëzueshme që ndodhet

në mesin tonë Ipeshkvi shumë i nderuar Imzot Dodë Gjergji”, kurse fëmijët i dhuruan një tufë me lule të bukura Ipeshkvit. Në fillim të vizitës Ipeshkvi i paraqiti popullit arsyen e pranisë së tij në Doblibare: “Kam ardhur me bashkëpunëtorët e mi – tha ai – për të parë punën që zhvillojnë meshtarit dhe motrat në famullinë e Doblibares”. Morën pjesë një numër i madh i besimtarëve të famullisë, gjatë lutjes së Udhës së Kryqit, po ashtu edhe në Meshën Shenjte, të cilën e udhëhoqi Ipeshkvi, është vënë re në fytyrat e besimtarëve dashuria e madhe që kanë për Zotin dhe Barinjtë e Kishës.

Pas Meshës Ipeshkvi bëri një



takim me Këshillin e famullisë, ku anëtarët shprehën shqetësimet e tyre kryesore mbi familjen, emigracionin dhe shkurorëzimet. Ipeshkvi theksoi arsyet kryesore që hasin në shkatërrimin e familjes së sotme: mërgimi, mungesa e dialogut mes burrit e gruas dhe materializmi e konsumizmi i tepruar në familje.

Në fund të mbledhjes, për këshilltarët u organizua edhe dreka e përbashkët. Takimi ishte shumë i përzemërt dhe të gjithë u ndanë të kënaqur.

Të nesërmen pati edhe një vizitë me drejtorin e shkollës dhe personelin e saj, ku i falënderoi për punën e madhe dhe të palodhshme që bëjnë për edukimn e brezave të ri, të cilët janë e ardhmja e Doblibares dhe fshatrave përreth. Ndërsa pasdite vizitoi disa të sëmure dhe familje të varfëra në famulli, si familjen e Mëhill e Gjergj Drenaj. Të sëmuret mbetën të kënaqur që patën mundësinë që edhe mes dhimbjeve të takonin Bariun e tyre.

Në ora 16.00 në Berdosanë, filialë e Doblibares, u kremtua Mesha Shenjte, ku Kisha ishte përplotë me besimtarë, me të rinj e fëmijë. Në pasdite vonë u mbajt takimi me të rinjtë, ku ipeshkvi foli mbi rolin e fesë në përcaktimin e vlerave dhe në veçanti theksoi se jeta e të riut s'ka kuptim pa vlera, pa sakrificë dhe pa ideale. Në mbrëmje u shtrua darka me Këshillin e famullisë dhe përfaqësuesit e të rinjve.

Të dielën, me 14 mars, në ora 11.00, si festë për të gjithë të krishterët, Kisha u mbush me plot besimtarë, ku mbledhen për të kremtuar Meshën Shenjte me Bariun e vet të dashur Imzot Dodë Gjergji. Famullitari falënderoi Ipeshkvin dhe bashkëpunëtorët e tij, për ardhjen e tij në këtë famulli dhe për hret e bekimet që ai i sjellë Kishës gjatë kësaj vizite baritore. Mund të konstatojmë se të gjithë besimtarët mbetën të kënaqur me vizitën e Ipeshkvit.

## Vizita baritore në famullinë e Lindjes së Virgjërës Mari në Bec

Të dielën, më 14 mars, edhe në famullinë e Becit në oborrin e Kishës kishin dalur një numër i madh i besimtarëve ta presin Bariun tonë. Kjo e dielë për Becin ishte e veçantë dhe shumë prekesë: në Meshën e orës 9.00, të udhëhequr nga Imzot Dodë Gjergji, Ipeshkvi ynë zyrtarisht e hapi vizitën e tij baritore në këtë famulli. Ipeshkvi gjatë predikimit theksoi rolin konstruktiv të Kishës dhe të prijësve të saj, të

cilët gjatë shekujve kanë shërbyer në ruajtjen e vlerave njerëzore, morale dhe fetare. Përfaqësuesja e të rinjve përshëndeti ipeshkvin, ndërsa famullitari falënderoi ipeshkvin dhe bashkëpunëtorët e tij për vizitën e tij baritore në këtë famulli.

Të martën paradite Ipeshkvi vizitoi familje të sëmure dhe varfër të famullisë. Ndërsa pasdite u takua këshillin e famullisë, ku ishin të pranishëm përfaqësues të të gjitha fshatrave të famullisë së Becit. Në këtë takim u propozua zgjerimi i objektit të vjetër në Lugun e Bunarit, ku kremtohet Mesha Shenjte dhe administrohen sakramentet. Ipeshkvi e mori në shënim këtë kërkesë, të cilën e quajti të drejtë, edhe pse për momentin nuk mund të realizohet, sepse ka përparësi tjera në Ipeshkvi, si ndërtimi i Katedrales Nënna Tereze në Prishtinë, ndërtimi i Kishës së re në Llapushnik. Gjatë diskutimeve u analizuan sjelljet dhe qëndrimet e Kishës ndaj fejesave, shkurorëzimeve, vrasjeve etj.

Më 17 mars, në ora 10.00, Ipeshkvi u ndal tek Shkolla e Becit, ku një turmë e madhe nxënësish, pa dallim feje, të udhëhequr nga drejtori dhe arsimtarët e tyre, i bënë pritjen dhe i dhuruan lule. Ipeshkvi iu drejtua fëmijëve me fjalët “të jenë sa më të mirë, të përparojnë në dije, të dëgjueshëm ndaj mësuesve dhe prindërve – dhe shtoi – në asnjë mënyrë të mos bëjnë dallime në fe, sepse të gjithë jemi vëllezër”. Pastaj u bë edhe një takim vetëm me drejtorin dhe profesorët e kësaj shkolle, ku Imzoti vendosi theksin mbi një formim të duhur dhe të përshtatshëm për fëmijët.

Më pas Ipeshkvi vazhdoi sërish vizitën e tij në Bec, ku u prit me gëzim të madh prej hoxhës dhe shehut të fshatit, u diskutua për marrëdhëniet ndërfaqetare mes bashkësive fetare në fshatin e Becit. Gjatë bisedës me përfaqësuesit e Bashkësive fetare, Ipeshkvi e vlerësoi bashkëjetesën ndërfaqetare në këtë zonë dhe theksoi se populli shqiptar është shembull për rajonin dhe më gjërë për kultivimin e marrëdhënieve të mira ndërfaqetare.

Në takim me të rinjtë Imzot Dodë Gjergji shpjegoi shumë mirë disa gjëra të nevojshme për familjen, kurorën e martesës dhe angazhimin aktiv në aktivitetet e famullisë. Sikur në Doblibare Monsinjori porositi famullitarin, që të krijohet një Këshill i të rinjve, të cilët do të jenë animatorët kryesor që do të promovojnë iniciativa e aktivitete brenda famullisë.

Ipeshkvi gjatë qëndrimit të



# t tonë Imzot Dodë Gjergji



në famullinë e Becit vizitoi edhe motrat Baziliane që shërbejnë në këtë famulli. Në këtë vizitë zyrtare Ipeshkvi shprehu falënderimet për kujdesin e mbarë bashkësisë, sidomos ato motra që shërbejnë drejtpërsedrejti në famulli e katekeze. Poashtu vizitoi edhe çerdhen e fëmijëve, që drejtohet nga motrat Baziliane.

Dhe mëqenëse me fundin e vizitës baritore po afrohej përjetimi i Javës së Madhe, pra i Mundimeve të Jezu Krishtit, u mendua që kjo vizitë të mbyllej me kremtimin e Udhës së Kryqit dhe të Meshës Shenjte, në ditën e premte pasdite më 19 mars. Në Meshën Shenjte ishin të pranishëm edhe Don Lush Gjergji, Don Shan Zefi, Don Kelmend Spaqi dhe Don Albert Jakaj.

## Vizita baritore në famullinë e Shën Rrokut në Novosellë

Të enjten, më 25 mars, vizita baritore do të vazhdonte në famullinë e Novosellës. Menjëherë pas arritjes së Ipeshkvit në ora 10.00, u bë Bekimi i Rrëfyestorëve të reja në këtë famulli. Deri në ora 10.45 ishte mundësia për rrëfime, sepse këtë ditë kjo famulli ka pas rrëfimet në nivelin e dekanatit.

Në ora 11.00 u bë vizita në shkollën fillore "Shtjefën Kurti" në Novosellë. Ipeshkvi, i shoqëruar nga famullitari dhe nga bashkëpunëtorët e tij, u mirëprit nga nxënësit dhe mësuesit e kësaj shkolle. Ipeshkvi pasi që i përshëndeti nxënësit dhe u përgjigj në çdo pyetje të nxënësve që kishin përgatitur për të. Po ashtu ipeshkvi zhvilloi takim me drejtorin e shkollës dhe

mësimdhënësit e saj, ku mbajti fjalën e rastit dhe foli për rolin e shkollës, si faktor i rëndësishëm në formimin e brezave të ri. Drejtori z. Tunë Frrokaj, në emër të kolektivit falënderoi vizitën e Ipeshkvit dhe e quajti atë ditë si ditë historike për shkollën e tyre, sepse për herë të parë në historinë e shkollës "Shtjefën Kurti".

Në ora 11.30 vizitoi Ambulancën e fshatit dhe u njoftua nga znj. Guse Hajdaraj rreth aktiviteteve të kësaj ambulance. Gjatë periudhës së luftës (1998-99) kjo Ambulancë ka merita të mëdha, sidomos për punën e palodhshme e personelit të bluzave të bardha me njerëzit e plagosur dhe të traumatizuar nga lufta.

Pasdite në ora 15.00 u kremtua Mesha në fshatin Plançor, filialë e famullisë së Novosellës. Famullitari Don Lush Sopi falënderoi Zotin për këtë hir të vizitës baritore të Sh.T. Imzot Dodë Gjergji në famullinë tonë. Prania e Ipeshkvit na gëzon dhe na bën të përjetojmë edhe më shumë bashkësinë e krishterë. Ipeshkvi gjatë predikimit nxiti besimtarët që të jetojnë Meshën dhe Fjalën e Zotit, të angazhohemi sa më shumë në transmetimin e vlerave të krishtera në shoqëri. Pas Meshës vizitoi Shtëpinë strehuese për fëmijë të braktisur në Plançor, ku përgjegjës ishte çifti i mrekullueshëm Zef e Bora Dedaj. Ipeshkvi përgëzoi për punën e madhe që bëjnë këta edukatorë për fëmijët e braktisur, në veçanti për suksesin e arritur në zhvillimin dhe afirmimin e strehimit familjar si formë e mbrojtjes për fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe krijimin e mundësive që fëmijët të gëzojnë të drejtën e tyre të rriten në familje.

Në mbrëmje ishte darka dhe takimi me Këshillin e famullisë, ku mes të tjerash diskutuan për gjendjen e mjerueshme të Kishës në fshatin Plançor. Famullitari u zotua se sivjet do të fillojnë me ndërtimin e Kishës së re dhe do të kenë mbështetjen morale edhe të Ipeshkvit tonë.

Kjo vizitë u pasua në Novosellën e Ultë, ku filloi vizitën me shkollën fillore "Engjëll Gjoni" të këtij fshati. Në oborrin e shkollës u prit nga nxënësit, drejtori dhe arsimtarët e shkollës. Në emër të arsimtarëve Ipeshkvin e përshëndeti drejtori z. Pjetër Geci, njëkohësisht e përgëzoi iniciativën e tij që gjatë vizitës së tij baritore, të vizitojë edhe shkollën fillore të Novosellës së Ulët. Pastaj u zhvillua edhe një takim vetëm me drejtorin dhe me profesorët e kësaj shkolle, ku Imzoti vendosi më shumë thek-

sin për një formim të duhur dhe të përshtatshëm për fëmijët dhe të rinjtë, të cilët do të jenë e ardhmja e vendit tonë.

Ardhja e Ipeshkvit u mirëprit edhe në shkollën fillore "Rilindja" në Dobrigjë, ku nxënësit dhe mësuesit e kësaj shkolle i dhuruan një mirëseardhje të ngrohtë e familjare.

Në ora 15.45, Kisha ishte mbushur përplot me besimtarë, të cilët kishin ardhur të lusin Udhën e Kryqit, që është simbol i vuajtjes dhe i kryqit të jetës sonë dhe ka kuptim nëse e mbartim Kryqin bashkë me Krishtin drejt Kalvarit. Pas Udhës së Kryqit pasoi Mesha Shenjte, të cilën e udhëhoqi Ipeshkvi. Menjëherë pas Meshës u zhvillua takimi me të rinjtë e famullisë. Aty Monsinjori, ndër të tjera, nënvizoi disa

këshilla të rëndësishme për të rinjtë, ku më rëndësishmja ishte që të rinjtë të mos kenë frikë të ndjekin Jezusin. Pas takimit u mbajt një program festiv në sallën e famullisë. Në mbrëmje, në darkë, ishte i ftuar edhe mysafiri special Dr. Pal Lekaj, Kryetari i Komunës së Gjakovës, i cili jeton dhe banon në famullinë e Novosellës, njëkohësisht duhet të theksojmë se është bamirës dhe dashamirës i Kishës Katolike.

Përfundimi i vizitës baritore në këtë famulli u zhvillua në të Dielën e Larit, më 28 mars, në ora 9.00, me ç'rast ipeshkvi i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në Meshën Shenjte dhe, në mënyrë të veçantë, i falënderoi famullitarin, motrat Françeskane të "Zojës së Papërlyer" e kësaj famullie dhe korin e kishës.







### Drita: Ardhja e dhe përcaktimi juaj për të shërbyer te populli shqiptar?

**Patër Lorenci:** Ardhja ime në Kosovë nuk ka qenë e planifikuar drejtpërdrejt prej meje, sepse me gjithë se për këtë nuk kam folur publikisht përpara, tash më duket se ka ardhur koha që pak a shumë të flitet edhe për këtë punë. Unë kam pasur gjithmonë, që prej fillimit, një ndjenjë thirrje për mision. E për misionet kam menduar më së pari misionet e Afrikës apo të Azisë, India apo Kina. Mirëpo provania e Zotit ka dashtë që unë të dërgohem si ushtar në ushtrinë e detyrueshme jugosllave në Kosovë, më së pari në Pejë për 10 muaj e pastaj edhe 5 muaj në Gjakovë. Në Gjakovë takova edhe bashkësinë françeskanë që vepronte aty prej vitit 1958. Këtu në Gjakovë ishin patër Emanueli, patër Hil Kabashi, që tash është ipeshkëv në Jugun e Shqipërisë dhe Patër Engjëllin, tash është në Shqipëri, në Laç. Në Gjakovë ata me priten jashtëzakonisht mirë e menjëherë shprehën dëshirën që ta mësoj gjuhën shqipe, e të vij për të shërbyer në Kosovë. Gjuha shqipe më dukej tepër e rëndë, kurrë nuk kuptoja, sepse nuk përngjante as në një gjuhë tjetër që e kam mësuar dikund e sadopak në shkollë. Nuk munda t'u jap kurrfarë premtimi, por gjatë studimit teologjik, pas ushtrisë, jam interesuar pak edhe për gjuhën shqipe, e kur kam parë se është e mundshme të mësohet, vija gjatë pushimeve verore në Gjakovë që sadopak ta dëgjoj dhe ta përmirësoj shqiptimin. U shugurova në vitin 1980 ditën e shën Pjetrit në Gjakovë, e mbe-ta derisa shkova në Shqipëri, e pastaj prej Shqipërisë prapë u ktheva në Gjakovë. Kështu që vetëm në popullin shqiptar kam shërbye.

### Drita: Si ishte gjendja në atë kohë në Kosovë, a kishte ngjashmëri me Bosnjen?

**Patër Lorenci:** Ka pas ngjashmëri mjaft të madhe, megjithëse ka pas edhe dallime. Të ngjashme ishin në disa aspekte. Së pari sepse edhe populli shqiptar në Kosovë edhe populli kroat në Bosnje ishin shumë shekuj nën sundimin otoman. I kemi pasur edhe traditat edhe problemet e

njëta, madje edhe fetërit kanë shërbyer edhe popullin në Bosnje, pastaj edhe popullin në Kosovë. Kështu që edhe traditat fetare i kemi pasur të njëjta. Ka pasur edhe dallime: gjuha, traditat kombëtare, gjendja familjare, e cila në Kosovë ishte pak më shumë tradicionale se sa në Bosnje. Familjet ishin këtu më të mëdha dhe më patriarkale. Lidhjet familjare ishin më të forta edhe ndër vëllazëri. Ka qenë një vetëdije e veçantë e shqiptarëve dhe një dallim i theksuar nga popujt tjerë të Jugosllavisë, sidomos nga Serbia e serbët. Ai dallim me një mënyrë ka mbajtur më tepër bashkë. Më tepër janë munduar që të jetojnë në mënyrë më të theksuar kulturën dhe traditën e vet, por edhe fenë e vet që mos të shkohet në ideologji, në pushtet, por t'i ruajnë traditat, kulturën edhe identitetin e tyre që dallohej prej kombeve tjera në Jugosllavi. Kështu që mund të them se edhe ato dallime edhe ato ngjashmëri më kanë ndihmuar te inkuadrohem më lehtë.

### Drita: Si e keni njohur ju patër Emanuelin?

**Patër Lorenci:** Unë nuk kam jetuar me patër Emanuelin, as nuk e kam njohur para se me ardhë në Kosovë. Kur erdha si ushtar në Gjakovë në Kuvendin e freterve ai ka qenë guardian këtu dhe me ka prit si të më kishte njohur 200 vjet përpara. Jam ndier në këtë shtëpi si shtëpinë time. Qëndrimin e tij i hapur jo vetëm ndaj meje, por ky qëndrim ishte i bukur edhe ndaj popullit shqiptar dhe angazhimi i tij për të mirën e popullit shqiptar, interesi i tij që të gjejë meshtarë tjerë që të bashkëpunojë këtu në Kosovë e të vazhdojnë shërbimin e popullit shqiptar më ka lënë përshtypje të veçantë. Edhe dëshmia e të tjerëve për të, sidomos e patër Engjëllit, e patër Hilit si edhe disa këshilltarëve të kishës që në atë kohë kanë ditur kroatishten më kanë folur sa të mira ka bërë patër Emanueli për popullin shqiptar. Kështu që kam krijuar një përshtypje se me të vërtetë patër Emanueli është njeri i shenjtë gjë që është treguar edhe më vonë në veprat e tij të tjera kur kishte punuar Bosnje e së voni edhe në Cetinje deri në vdekje e tij në vitin 1988.

Intervistë me patër Lovro Gavran, provincial i françeskanëve të Bosnës  
Patër Lovro është i njohur në Kosovë e Shqipëri si Patër Lorenci

# Tridhjetë vite ndër shqiptarë

### Drita: Kur është hapur Shqipëria, ju e keni lënë Gjakovën keni shkuar atje. Si e gjetët Provincën Françeskane edhe Kishën në Shqipëri?

**Patër Lorenci:** Ishte viti 1991, faktikisht në nëntor 1990 është lëshuar populli në Shqipëri dhe i kanë hapur kishat me zor. Mund të them me zor edhe pse partia komuniste e kishte kuptuar se më nuk mundet për të qëndruar ashtu si ka qenë. Në atë kohë ende nuk ishte pranuar asnjë meshtar i huaj. Ardhja e parë e te "huajve" në Shqipëri ka qenë ardhja e Nenës Tereze në mars të vitit 1991. Kur ka ardhur Nenë Tereza, atë ditë kemi dashtë të shkojmë edhe ne nga Kosova. Ishim paraqitur unë, patër Engjëlli, don Gjergj Gjergji e disa të tjerë dhe kemi organizuar një autobus, mirëpo kur push-teti në Shqipëri ka pa se mund të vijnë shumë mysafirë nga bota e jashtme, kanë pasur frikën se e humbin kontrollin mbi atë turmë të popullit, nuk lejuan të hyjë autobusin. Pastaj tentuam të hyjmë me një makinë të vogël, por as aty nuk na lejuan. Asaj radhe nuk patëm sukses, por me Patër Antonin edhe një frat laik shkua në tetor. Por kemi shkuar nëpër Romë. Në Romë kemi marrë vizën më lehtë dhe kemi qëndruar dy javë për të parë gjendjen. E ajo ishte më e vështirë se sa mund të parashihej. Por ne patëm vendosur të shkojmë sado që të jetë rëndë. Na tha-në se është shumë vështirë, sepse populli është shumë i varfër, por në kishim vendosur të jetojmë aty ku jeton ai popull. Ku mund të jetojmë shqiptarët mund të jetojmë edhe ne. Ky vendim yni u mirëprit nga eprorët dhe me atë rast na kanë dhënë dekretin që mund të shkojmë. Kështu që para Krishtlindjes, më 20 dhjetor shkova në Shqipëri, pas pak erdhi edhe patër Antoni. Kështu kemi vazhduar punën, aq sa patëm mundësi në bashkëpunim me dhjetë fetërit që i gjetëm gjallë atje. Dy prej tyre ishin të sëmurë e nuk mund të punonin Patër Aleks Baqli ishte përfaqësues i fetërve në kapitullin gjeneral. Gjatë kësaj kohë edhe u sëmur e qëndroi atje deri në vdekje. Edhe fra Salvador Hajmeli ishte i sëmurë, e të tjerët kanë punuar

aq sa kanë pasur mundësi. Së pari kemi organizuar pak a shumë shërbimin në Shkodër, në Lezhë e në Laç, kurse disa që ishin fizikisht pak më të fortë si patër Robert Hashta e Patër Konstadini Pistulli ata kanë shërbyer edhe në Malësi nëpër bjeshkë kështu kemi filluar pak nga pak deri sa është stabilizuar situata që prej fillimit kemi bashkëpunuar edhe ne fakt kemi ardhur para Nuncit Apostolik.

Ata na kanë ndihmuar shumë e sidomos Pater Zef Pllumbi po ashtu na ka ndihmuar shumë, sepse dy muajt e parë nuk kishim ku të banojmë e kemi banuar në shtëpinë e nipit të tij ku banonte edhe patër Zefi sepse patër Zefi nuk kishte shtëpi të vet po ashtu na ka ndihmuar edhe patër Shtjefën Pistulli, se ai ka jetuar në Shkodër, kur vëllai i tij patër Konstantin Pistulli ka jetuar në Kastrat atë e kemi vizituar ndonjë herë, por d.m.th nuk kemi pas shumë kontakt më të deri sa ishte larg prej Shkodrës por këta na kanë ndihmuar pak a shumë që janë kujdesuar më së pari për banesën mandej edhe për ushqimin, derisa kemi hyrë në kuvendin e vjetër në Gjuhadol.

Gjuhadori ishte çerdhe e fëmijëve kur kanë kuptuar këta punëtorët e çerdes se kjo do t'i dorëzohet Kishës, do t'i kthehet Kishës, që populli nuk lejon ma që të jetë çerdhja, por duhet me qenë prapë Kuvendi i Fretërve. Kanë vjedhë çka kanë mundur, çka ka pasur në ta, mirëpo nuk ka pasë shumë gjëra, por kanë vjedhë shumicën e gjerave deri tek gjërat elementare. S'kemi mundur me i mbyllë as derën e as dritaren, kurse shkollën e parë në gjuhë shqipe që kishte hapur patër Gjergj Fishta ata e kishin djegur për mos më ra në duar të fetërve.

### Drita: Pastaj ju keni shkuar në Iballë dhe atje keni qëndruar mjaft gjatë?

**Patër Lorenci:** Po, do të thotë kur asht stabilizuar pak a shumë gjendja në Shkodër menjëherë në vitin e parë kemi marre seminaristët. Së pari 6 seminaristë kanë filluar studimin në kryeipeshkvi deri në vjeshtë, në vjeshtë kemi pasur 19 seminaristë, të gjithë kanë banuar tek ne në Gjuhadol e pastaj në vitin 1994 është hapur

edhe noviciati, pas një viti ata kanë qenë të gatshëm me i dhanë kushtet e para.

Në vitin 1995 d.m.th dy vjet pas ardhjes së papës është bërë kapitulli i parë i Provincës Françeskane Shqiptare me ata fetërit të vjetër të Shqipërisë me ne që kemi ardhur prej provincës së Bosnjës d.m.th prej Kosovës, dy ishin Hercegovina e pastaj ishin disa polakë, e ma se shumti ka pasur misionarë prej Italie, të gjithë së bashku kemi mbajtur kapitullin, ku është emëruar udhëheqja e re e Provincës Françeskane Shqiptare. Provincial u zgjidh patër Flavio Cavolini, kështu që unë që e kam pasë rolin e vice-delegatit të Rregullit Françeskane për Shqipëri, e delegat ishte një italian, **patër Giamaria Polidoro**, unë pasi e kam kryer këtë detyrë të vicedelegatit, shkova prej Shkodrës në Iballë, sepse në atë zonë nuk kishte shërbyer askush, nga 2 herë kanë shkuar fretnit, ka shkuar patër Dionis Makaj, i cili kishte shërbyer aty 12 vjetët e fundit para se të mbyllen Kishat, e një herë kemi arritur të shkojmë atje me patër Ilija Kovaçeviq, patër Ilija megjithëse ka shërbyer në Gjakovë, sikur edhe patër Engjëlli e patër Ambrozi ku kohë pas kohe vinin nganjëherë me shërbye në Shqipëri. Unë në atë kohë shkova në Iballë ku qëndrova 6 vjet derisa arrita me ndertu Kishën dhe Kuvendin Françeskan, ku atëherë u ktheva në Kosovë.

### Drita: A ishte dallimi i madhe në mes të asaj çka keni gjetë ju në Shqipëri dhe çka keni lanë në Shqipëri, kur jeni kthyer në Kosovë?

**Patër Lorenci:** Dallimi ishte mjaft i madh, sepse faktikisht filimi ishte gati nga zeroja. Ishte një dëshirë që të ripërtërihet feja dhe provinca. Nuk kemi pasur asgjë, as libra, por faleminderit Zotit ndërkohë na kanë arrite. As Mesharin ende nuk e kemi pasë kur kemi shkuar në Shqipëri, nuk e kemi pasur as këtu në Kosovë. Meshari në gjuhën shqipe është shtypur në mars të vitit 1992, e ne kemi shkuar në Shqipëri në fund të vitit 1991, me ciklostil kemi pasur librat e meshës, meshari pra atëherë është botuar më vonë, më 1994 asht botuar Bibla e plote. Kështu



që nuk patëm mundësi me pasë të shtypur as librat e leximeve të meshës, leximet e meshës së bashku me msgr. Zef Gashin i cili atëherë ishte drejtor i institutit katikistik kombëtar, me msgr. Zefin e me don Domenik Qerimin ishte edhe një motër Odet, kemi ba korrigjimin e librave të leximeve në fillim të vitit 1994 në Romë, e atë vit janë botuar leximet e meshë. Këto janë botuar një vit pas shugurimit të 4 ipeshkvijve të Shqipërisë, d.m.th ipeshkvit janë shuguruar nga papa Gjon Pali i II-të, në ditën e shën Markut më 25 Prill të vitit 1993. Kështu që fillimi ka qenë gati nga zero, mirëpo me ndihmën e Zotit, dhe më angazhimin e të gjithëve, janë zhvilluar shumë gjëra e janë krijuar edhe kuvendet e para janë krijuar edhe bashkësitë e është stabilizuar veprimi Problem tjetër në Shqipëri ka qenë se nuk dinin thujse asgjë për Koncilin e Dytë të Vatikanit, Kishat janë mbyllë në vitin 1967, dy vjet pas Koncilit të Vatikanit. Shqipëria ishte e mbyllur e nuk kishte kontakte më botën e jashtme, kështu që rezultatet e vendimeve të Koncilit të Dytë Vatikanas nuk kanë depërtuar në Shqipëri, kur kemi ardhur ne në Shqipëri, meshtarët e vjetër e thoshin meshën vetëm latinisht, ne kemi filluar meshën në shqip, kështu që kemi pasur mjaft kundërshtime me meshtarët e vjetër, sepse kanë menduar se do ta prishim, do ta largojmë popullin me meshën në gjuhën shqipe, se populli din meshën vetëm në latinisht, u kemi thënë se në latinishten e respektojmë, por ne kemi thanë meshën shqip dhe do t'iu shpjegojmë popullit dhe domethëniet e riteve, dhe pak nga pak populli do të mësohet. Dhe me të vërtetë populli ka pranuar shumë shpejt e shumë mirë, më lehtë e ka pranuar populli meshën në gjuhën shqipe, se sa meshtarët e vjetër të cilët faktikisht kurrë më përpara nuk kanë pasë as tekste e as mundësi me thanë meshën shqip.

**Drita: Tani jeni provincial i Provincës Françeskane të Bosnjës. Çka mund të na thoni për këtë provincë?**

**Patër Lorenci:** Provncia Françeskane e Bosnjës është një prej 110 provincave të Rregullit Françeskan në botë, mirëpo është një prej provincave më të vjetra. Fretërit në Bosnje kanë ardhur në vitin 1291, nuk kanë ardhur rastësisht, por i ka thirrur qeveritari, vëllai i mbretit Orosh, vëllai i tij ka qenë sundues në Bosnjën Lindore, ai ka thirrur prej Romë dy françeskan që të mos akuzohet populli rrejshme që nuk janë katolik të vërtetë, sepse Hungaria kishte pretendime që ta sundonte Bosnjën dhe kishte për shkas se këta janë heretikë.

Në vitin 1517 kur Rregulli Françeskan është ndarë në provinca, Provinca Françeskane e Bosnjës u bë province e pavarur dhe ajo ka mbuluar gjithë Bosnjën e asaj

kohe, jo vetëm si është Bosnja tani, por edhe të gjitha zonat që e mbulonte pushteti otoman, pse ashtu, sepse kur Bosnja ka ra nën pushtetin e turqve në vitin 1463 domethënë 5 vjet para vdekjes së Skënderbeut, atëherë provinciali i Bosnjës fra Angiello Zvizdoviq ka dalë para sulltanit dhe ka kërkuar prej tij një dokumente, faktikisht para se të kërkojë atë dokument, e ka pyetur: e ke pushtetin, e ke pushtuar Bosnjën, a e do ti tokën pa popull apo me popull, a do ti që ta sundosh tokën apo do që dikush ta punojë tokën? Populli do të rrijë, por populli nuk do të rrijë në Bosnje thotë provinciali, nëse nuk ia jepni lirinë e fesë e nëse fretërve nuk u jep lirinë që të punojnë me popull që t'i shërbejnë popullit. Lirinë e fesë ju jap, fretërit mund të veprojnë derisa të respektojnë pushtetin otoman. Atëherë ka lypë dokumentin e ia ka dhënë një dokument që edhe sot ruhet në Kuvendin Françeskan të Fojnicës d.m.th. dokument, i cili ia garanton lirinë e fesë popullit, edhe veprimin fretërve, kuptohet ky dokument nuk është respektuar gjithmonë, pak është respektuar, por ishte një bazë për të pasur mundësi për të kërkuar liritë fetare, atëherë kur i janë mohuar e atëherë kur pushteti nuk lejonte fretërve veprim, kështu që fretërit në bazë të atë dokumenti gjithmonë ku ishte pushteti i turqve mund të shkonin e mund të predikonin Ungjillin. Për këtë arsye Provinca Françeskane përfshinte të gjitha tokat e okupuara prej turqve, kështu që fretërit e Bosnjës me shekuj kanë vepruar edhe në Shqipëri, kur të tjerët nuk mund të vepronin si qytetarë të huaj, por fretërit e Bosnjës pasi që ishin edhe brenda për brenda Turqisë, e cila i njihje fretërit e Bosnjës si qytetarë të shteti të vet, lejonin që fretërit e Bosnjës të vepronin në kufijtë e saj, kufijtë e Turqisë, e në këtë mënyrë kanë pasur mundësi ta japin një ndihmë që të ruhet feja edhe në këto zona, të cilat përndryshe kanë mbetur pa meshtarë të vet, për arsye të preokupimit otoman. Mandej kur liroheshin zonat e ndryshme nga pushteti turk, atëherë prej Provincës së Bosnjës është nda provinca e Hungarisë, pastaj provinca e Dalmacisë e Zarës, e mandej Provinca e Kroacisë e Bosnja ka mbete në kufi të Bosnjës. Zonat këtu Kosova, Mali i Zi e Shqipëria, kanë pasur provincën e vet, provincën e pavarur, të cilës Provinca e Bosnjës i ka ndihmuar në veshtirësi, por ishin province në veti, vetëm pas luftes së Pare Botërore kur është zhdukë prej këtyre zonave në luftërat ballkanike pushteti otoman e pas luftës së Parë Botërore kur është krijuar kufi i fortë ndërmjet Shqipërisë e ish-Jugosllavisë u bë i pamundshëm komunikimi i fretërve të Kosovës e të Malit të Zi me provincën e vet në Shqipëri, atëherë Roma ka lejuar që Provinca e Bosnjës ta marrë në kujdes Kosovën, e

Provinca e Zarës të marrë në kujdes fretërit në Malit të Zi, kështu që deri më sot është gjendja e tillë. Provinca e Bosnjës pra shërben Kosovën kështu që fretërit e Kosovës i përkasin Provincës së Bosnjës kurse ata të Malit të Zi i përkasin Provincës Françeskane të Zarës së Kroacisë.

**Drita: Bosnja ka tre popuj, tri fe. Populli shqiptar është një popull me shumë fe. A mund të kenë këta popuj një ardhmëri në paqe me gjithë këto fe e dallime të mëdha?**

**Patër Lorenci:** Ndarja e fesë së krishterë është bërë para ardhjes së turqve, në vitin 1054 është ndarë Kisha Katolike nga Kisha Ortodokse, për shkaqe fetare, por më tepër janë ndarë për shkaqe politike. Kur kanë ardhur turqit në vitin 1453 në Konstadinopojë, në atë kohë është islamizuar edhe populli shqiptar edhe i gjithë populli që ishte nën pushtimin otoman. Fati i popullit shqiptar ka qenë se ka pasur një gjuhë krejt tjetër të veçantë, që ka dalluar edhe nga greqishtja edhe nga sllavishtja edhe nga latinishtja. Dhe kur janë islamizuar shqiptarët, ata kanë mbetë të vetëdijshëm se janë shqiptarë. Gjuha shqipe nuk i përngjante asnjë gjuhe tjetër përreth, dhe kjo ka ruajtur vetëdijen e shqiptareve se janë shqiptarë edhe pse kanë ndryshuar fenë.

Në Bosnje turqishtja kurrë nuk ka depërtuar me shumicë, (sikurse flitet në Prizren turqisht edhe sot). Në Bosnje turqishtja nuk flitej kurrë askund, fjalët turke kanë hyrë në popull, e ka pasë njerëz që e kanë ditur turqishten, por populli kurrë s'ka folur turqishten. Ka folur vetëm sllavishten. Pasi të gjithë kanë folur të njëjtën gjuhë, por nuk ishin nën të njëjtën kishë. Ortodoksët ishin nën Kishën Ortodokse, e cili ishte nën sundimin e patrikut të Stambollit, katolikët ishin nën Kishën Katolike. Kroatët kanë jetuar nën Kishën katolike. Kur ka ardhur koha e zgjimit kombëtar që ka ndodhe shumë vonë edhe në përfundim p.sh. në shekullin 17-të e 18-të, ka ardhur deri te zgjimi kombëtar, atëherë kanë shikuar ku janë dallimet. Dallimi është te feja. E pasi feja ortodokse në Bosnjë i përngjante serbëve në Serbi, janë shpallur serb, megjithëse nuk ishin në Serbi por ishin në Bosnjë. Tjetër, pasi që feja e një pjese kroate katolike në Bosnjë ishte e njëjtë me fenë e kroatëve, katolikët e Bosnjës janë shpallur kroatë, megjithëse kanë jetuar në Bosnjë, nuk janë quajtur boshnjakë, por kroatë. Këta që nuk kanë pasë as fenë serbe e as fenë kroate, janë shpallur boshnjakë. Në Bosnjë ata që nuk ishin serbë e nuk ishin as kroatë, kanë thanë se ishin turq. Kur është larguar Turqia me anketimin e Bosnjës në vitin 1909, këta më nuk kanë pasur mundësi me thanë jam turk. Ata që kanë thanë jam turk, kanë shkuar në Turqi qysh në kohën e Austrisë.



“ Duhet të jetojmë atë që e predikojmë, sikurse thuhet me rastin e shugurimit të xhakonit: Lexo ungjillin e mundohu të kuptosh e të besosh atë çka lexon. Çka beson prediko, e atë çka predikon jetoje. ”

Shumica nuk kanë shkuar atje se nuk kanë ditur turqisht. Më vonë të tillët kanë thanë jemi myslimanë, ku kanë shpallur fenë dhe kombësinë myslimane. Kjo ndodhi në kohën e Xhemajl Bjediqit, (në kohën e Titos) kur u është dhënë çdo kujt mundësia të shpallen çfarëdo kombi. Kështu që kanë krijuar kombësi të reja. Ndërsa ata që ishin me fe dhe kombësi të përzier, veten shpesh e quanin jugosllav.

Ardhmëria ekziston, në qoftë se ne këto dallime i shfrytëzojmë si një pasuri e jo si një burim konfliktesh, sepse çdo fe ka të mirat e veta. Në qoftë se ekskluzivisht dua për të theksuar vetëm një fe ose vetëm një kombësi këtu është konflikti, e në qoftë se respektojmë njeriun në atë traditën e tij, kulturën e tij, në gjuhën e tij, në idenë e tij në dëshirën e tij, por duke kërkuar prej tij po ashtu të respektojë edhe ai dallimet tona, dallimet e bashkësive tjera, atëherë krijohet një bashkëpunim i gjithanshëm. Mund të themi i hapur për të gjithë, për bashkëpunime edhe më të gjera ndërkombëtare. Në qoftë se arrijmë në atë drejtim për të krijuar dialogun, atëherë ka ardhmëri patjetër. E ardhmëria jonë më në fund ka me qenë në Evropë, sepse ne jemi Evropë gjeografikisht. Por para se të inkuadrohemi duhet ti pranojmë ligjet evropiane, të cilat respektojnë çdo fe, çdo kombësi. E në qoftë se ato i pranojmë jo vetëm parimisht por edhe praktikisht, atëherë ajo na garanton ardhmërinë e mirë, e jo konfliktin i cili na rrezikon ekzistencën.

**Drita: Ky vit është viti meshtarak, çfarë duhet të jetë një meshtar i shekullit 21?**

**Patër Lorenci:** Me folë për një meshtar e për meshtarinë në përgjithësi, duhet shumë kohë e mund të shkruhen libra e jo intervista.

Mendoj se meshtari sot duhet të jetë para se gjithash meshtar nga populli. Dëm i madh është që populli shqiptar nuk ka meshtarë të mjaftueshëm. Sidomos në Shqipëri mungojnë shumë. Në Kosovë ka mjaft meshtarë, po jo sa duhet. Meshtari duhet me qenë për popullin e vet dhe me popullin e vet. Kisha katolike kurrë nuk imponon fenë. Feja nuk mund të imponohet, feja mund të ofrohet, mund të hapet dera e përparimi i një të mire, mund të ofrohet një e mirë, por nuk mund të imponohet. E për këtë arsye së bashku me popull duhet të veprojnë në zhvillimin e atyre virtyeteve dhe përvetësimin e virtyeteve e vlerave, të cilat i ka feja katolike. Meshtari kërkohet të jetë udhëheqësi i popullit. Si prijës i popullit, si drita e botës, si kripa e tokës, si ai që i pari jeton ungjillin. Duhet të jetojmë atë që e predikojmë, sikurse thuhet me rastin e shugurimit të xhakonit: Lexo ungjillin e mundohu të kuptosh e të besosh atë çka lexon. Çka beson prediko, e atë çka predikon jetoje. E atëherë jemi meshtarë si duhet. Atëherë jemi ata që do të jenë të dobishëm për popullin e që do të jenë me të vërtetë drita e popullit të vet.

*Intervistoi:  
Patër Ndue Kajtazi*



# Letnica – oazë shpirtërore për besimtarë

■ PËRGATITI:  
Don Kristë GJERGJ

Nuk besoj që ka besimtarë katolikë në Kosovë e më gjerë që nuk ka dëgjuar, apo të mos ketë shtegtuar së paku një herë në Letnicë tek Zoja Černagore, në shenjtëroren e bukur të Ipeshkvisë sonë, tek Nëna jonë qiellore, e cila me shekuj i pret fëmijët e vet për t'i dëgjuar, ngushëlluar, këshilluar, ndihmuar në jetën e tyre. Vetëm Ajo mund ta dijë sa lutjet, njetet e lotët janë derdhur tek këmbët e Saj. Vetëm Nëna jonë qiellore mund ta dijë sa mrekullitë iu ka bërë njerëzve të të gjitha besimeve, duke e shpërblyer besimin e tyre. Po, para kësaj Nënë edhe Martirët tanë (1846 – 1848) u forcuan për t'i mbetur besnik Birit të Saj Jezu Krishtit dhe Atdheut tonë.

Jo vetëm në të kaluarën, por edhe sot është kënaqësi të shohësh familjet së bashku, apo edhe besimtarët tjerë, fëmijë, të rinj e të moshuar, shpesh edhe zbathur, me rruzare në dorë si shtegtojnë këmbë tek kjo Nënë e dashur. Dhe përfundimi i vetëm është ky: Sa të fortë në fe? Besimi i tyre nuk mund të mos jep frytë! Mirësia e Zotit, dhe dashuria e Zojës, do të sjellin ditë më të lumtura dhe të mira shpirtërore për të gjithë, pa tjetër!

## Fshati Letnicë

Emrin e fshatit disa studiues mundohen ta nxjerrin nga gjuhët sllave – letnikovac që. d m th vend verimi. Kinse dikur anëtarët e familjes mbretërore të Nemanjiçëve, paskan pasur një shtëpi të tillë këtu. Por pasi që nuk ka fakte historike, askush nuk e mbron këtë argument. Më afër të vërtetës është se emërtimi Letnicë vjen nga fjala letnja – letten dhe do thotë gur kali ose edhe i kaltër. (Shih M Pavlovič Ostaci dubrovackih i saskih govornih osobina fq 298). Fshati në fjalë gjendet buzë maleve të Karadakut – Maleve të zeza, në kufij me Maqedoninë, 15 km larg qendrës komunale – Vitisë.

## Famullia dhe Kisha

Nuk dihet saktë fillimi i famullisë së Letnicës. Mirëpo, sipas disa pllakave të gjetura rreth kishës së vjetër dhe varrezave (v 1511 dhe tjetra 1600), mund të supozohet se edhe para këtyre viteve ka pasur katolikë në këtë vend dhe ndoshta edhe famulli. Në dokumentet kishtarë kjo famulli përmendet si Montenegro, Montenegro di Scopia, Montenegro in Servia.

Kisha e sotme i është kushtuar të Ngriturit të Zojës në Qiell. Por dikur nuk ishte kështu. Në vitin 1617 në Letnicë u mbajt një sinod kishtar, kurse ipeshkvi i



“ Ja si e përshkruan atmosferën festive arqipeshkvi ynë Mons Dario Buçarelli në vitin 1871: Ditën e Zojës Madhe, por edhe më herët, një mori njerëzish shpejtojnë kah Letnica. Disa këmbëzbathur e duke ecur këmbë që t'i plotësojnë kushtet e tyre, të falënderohen për huret e pranuar, ose edhe t'i porositën Zojës për ndonjë rast të veçantë. ”

atëhershëm Mons Pjetër Mazreku, thotë se ajo është mbajtur në kishën famullitare të shën Gjergjit. Këtë fakt më vonë na e vërteton edhe arqipeshkvi i Tivarit, administratori ynë Mons Gjergj Bardhi. Ai në dy sinodet e mbajtura në v 1639 dhe 1642 thotë se kisha famullitare në Letnicë i është kushtuar shën Gjergjit. Ndërsa në vitin 1671 vizitatori apostolik Imzot Shtjefen Gaspari duke lajmëruar Kongregatën thotë se në Letnicë është kisha famullitare e shën Gjergjit dhe një tjetër e të Ngriturit të Zojës në Qiell.

Cila është historia që u themelua shenjtërore e famshme në Letnicë? Si dhe kur është bërë ky ndërrim? Burimet historike nuk flasin asgjë për këtë. Edhe nëse ka pas ndonjë që ka fol për këtë fakt, mjerisht rrethanat e kohës, pushtimet e egra, tërmetet, zjarret e shumta që kanë shkatërruar objektet bashkë me arkivat kishtarë.

Sipas burimeve historike, mund të zgjedhim këtë përfundim: katolikët e Shkupit, pas disfatës së madhe të ushtrisë austriake nën udhëheqjen e gjeneralit Pikolomini në v 1690 përkrah të cilit kundër turqve luftuan edhe shqiptarët e Kosovës, duke shpresuar se kishte ardhur koha të liroheshin nga zgjedha otomane, duke braktisur Shkupin morën me vete edhe truporën e Zojës. Strehim gjetën në fshatin të largët e të fshehur të Letnicës, të sigurt nga osmanët që pa mëshirë dën-onin popullatën vendase.

Vizitatori në fjalë, pra Sh Gaspari duke folur për kishën e Shkupit thotë se ishte shumë e nderuar. E kjo veçori ka të bëj,

jo me kishën si ndërtesë, por me truporen që gjendej në të. Kjo trupore gjeti strehim në kishën e Letnicës. Dhe kështu filluan të tuboheshin shumë besimtarë dhe të fliteshin për huret e shumta që filluan t'i fitojnë duke u lutur para Saj. Më vonë me lejen e Ordinarit, u ndryshua edhe titulli i kishës, duke iu kushtuar Zojës së Bekuar. Në favor të këtij mendimi flet edhe tradita e krishterë se Zoja e Bekuar mrekullisht kaloi prej Shkupit në Letnicë.

## Truporja dhe himni i Zojës

Truporja e Zojës është e punuar nga druri i blinit, me një vlerë të madhe artistike, sipas analizave që i janë bërë para Luftës së Dytë Botërore. Ajo paraqet Zojën të ulur, me Krishtin e vogël në prehër, kurse në dorën e djathtë mban një mollë. Nuk dihet autori as koha kur është punuar kjo trupore.

Ne kemi edhe himnin e bukur në gjuhën tonë N'Černagore kem një nanë... Nuk dihet se kur është shkruar ky himn i bukur që tregon dashurinë e madhe ndaj Zojës. Gjatë shekujve është pashtruar gjuhësisht. Dhe ne duhet të ruajmë atë si lutjen më të bukur që kemi, amanetin e stërgjyshërve tanë, të cilët në kushte shumë të vështira na e ruajtën besimin katolikë. Ja si e përshkruan atmosferën festive arqipeshkvi ynë Mons Dario Buçarelli në vitin 1871: *Ditën e Zojës Madhe, por edhe më herët, një mori njerëzish shpejtojnë kah Letnica. Disa këmbëzbathur e duke ecur këmbë që t'i plotësojnë kushtet e tyre, të falënderohen për huret e pranuar, ose edhe t'i porositën Zojës për ndonjë*

*rast të veçantë. Sa bukur është kur të shohësh ata që vijnë për të lavdëruar Hyjllindësen në gjuhë të ndryshme, nga popujt dhe besimet e ndryshme... Këtu të gjithë e ndjejnë vetën se janë fëmijët e një Nënë të përbashkët, e nëpërmjet të saj edhe fëmijët e njëjtat Atë të amshuar.*

## Letnica sot

Fillimi i luftës në Kroaci e shqetësoi pa masë popullin kroat të famullisë së Letnicës, Vërnakollës dhe fshatrave tjera sa që filloi shpërngulja e tyre kolektive në Kroaci. Ky eksod i tyre vazhdoi edhe më shumë pas luftës së fundit në Kosovë. Sipas statistikave janë shpërngulur në Kroaci rreth 6000 besimtarë. Në vitin 2000 pas një periudhe relativisht të gjatë emërohet famullitar një priftë shqiptarë – Don Kristë Gjergji. Famullia sa i përket besimtarëve ka pak shumë: 55 persona kroat, pleq e të vetmuar të cilëve iu nevojitet kujdes permanent nga ana jonë. Dhe 155 shqiptarë katolikë të ardhur nga Stubla, Kabashi, e Peshteri, pas luftës në Kosovë. Nën përkujdesjen tonë pastorale janë edhe Vërnakolla, dikur famulli, ku është kisha e bukur kushtuar shën Françeskut të Asizit, e ku jetojnë vetëm 5 besimtarë, si dhe kapela e shën Rrokut në Shashare me 15 besimtarë. Është e dhimbshme të shohësh shtëpitë e zbrazëta të Letnicës dhe fshatrave tjera të famullisë sonë – rreth 900 shtëpi. Në vitin 2001 nga lufta në Maqedoni në territorin e famullisë sonë u vendosën 1500 refugjatë shqiptarë nga fshatrat e brezit kufitar. Ata me lejen e organeve kompetente u vendosën nëpër shtëpitë kroate.

Ne iu dolëm në ndihmë me gjëra ushqimore e veshmbathje. Shumica prej tyre tashmë janë kthyer nëpër shtëpitë e tyre, por ka edhe të tillë që ende jetojnë nëpër këto shtëpi.

Në famulli përpos famullitarit është edhe don Gjergj Gjergji, si dhe motrat e shën Vinçencit që punojnë në kuzhinë dhe ambulancë, e që vizitën dhe barnat i ndan falas.

Festa qendrore është të Ngriturit të Zojës në Qiell apo Zoja Černagore, që kremtohet më 15 gusht, e në të cilën marrin pjesë edhe shumë njerëz të besimeve dhe kombeve të tjera. Festës i paraprinë përgatitja shpirtërore prej 9 ditëve me meshë e predikime, si dhe mundësia për rrëfime. Kohët e fundit në natën e festës ipeshkvi ynë me meshtarët tjerë dhe besimtarët e shumtë nga kisha e Zemrës Krishtit në Viti e deri në Letnicë shtegtojnë këmbë. Pastaj solemnisht kremtohet edhe shën Rroku (16 gusht), Zoja e Vogël (8.IX), Zoja Nunciatë (25. III). Po ashtu, është i rëndësishëm edhe përfundimi i muajit maj, kur shtegtojnë të gjitha famullitë e Kosovës. Jeta pastorale është në nivel: mësimi i fesë për të gjitha klasat e shkollës fillore, takime me të rinj, të parat premte të muajit etj. Pjesëmarrja e besimtarëve në meshë është shumë e lartë.

Vlen të theksohen edhe vizitat e shumta nga personalitetet ndërkombëtare dhe vendore, si dhe të shtegtarëve të shumtë nga Kosova e më gjerë dhe të besimeve të ndryshme, të cilët tregojnë për huret e shumta që fitojnë prej Nënës sonë qiellore.



Recension


## Zbulimi i së Shenjtës përmes të Shenjtit

*Përjasje për librin Shën Filip Neri (shenjt i haresë) i autorit Roberto Brunelli e shqipëruar nga don Pal Tunaj dhe Don Jeton Thaqi. Botoi “Drita” Prizren 2010.*

■ SHKRUAN:  
**Vilson CULAJ**

Këto ditë shtëpia botuese “Drita” e cila vepron në kuadër të ipeshkvisë se Kosovës nxori në dritë botimin me të ri Shën Filip Neri të autorit Roberto Brunelli të cilin libër me një punë përkushtuese e shqipëruar dhe sot ia ofrojnë lexuesit shqiptar don Jeton Thaqi dhe don Pal Tunaj. Është ky një libër, i cili lexuesit i ofron mundësinë për t’u njohur me figurën, personalitetin, butësinë, dashurinë, mirësinë, profecinë dhe shenjtërinë e këtij biri të kishës, i cili tërë jetën e tij ja përkushtoi fesë dhe dashurisë ndaj njeriut dhe Zotit.

Në hyrje të librit janë përshkruar disa të dhëna kronologjike për Filip Nerin duke filluar nga lindja e tij më 21 qershor 1515, transferimin e tij në Rome, shugurimin e tij për meshtar me 1551, aktiviteti i tij jetësor e deri me kalimin e tij në amshim me 1595. Libri është i ndarë në gjashte kapitla të veçanta, ku secila në vete përshkruan shtegun e jetës dhe aktivitetin e këtij meshtari dhe me vonë të shenjtit Filip Neri. Në pjesën e parë “Fëmijëria dhe rinia e Filip Romolo Nerit” fillimisht përshkruhet pagëzimi i tij më 22 korrik 1515 në kishën e Shën Gjergjit. Vdekja e se ëmës më 1520 dhe martesa e dytë e babait të tij . Nga ky libër dhe fakte të tjera del se Filip Neri ishte një fëmijë i dashur, shakaxhi, i dëgjueshëm dhe sipas rrëfimeve të motrës se tij del se ai kishte një karakter shumë të butë e të hareshëm prandaj e quanin edhe “Filipi i mirë”. Mësimet e para i kishte marr në shkollat publike ku njoftohet më për se afërmi me veprat e etërve të kishës, por formimin e tij shpirtëror kishte arritur ta thellonte në dhomat e kuvendit dominikan të Shën Markut. I gjendur në mes të dilemës për t’u marrë me tregti apo t’i përkushtohej zotit, Filipi vendos t’i braktiste pasuritë e botës, të cilat ia kishte ofruar tradita familjare për ta ndjekur gjatë tërë jetës së tij mësimin e Jezusit. Nga niveli i studentit Filipi ngritët edhe bëhet një edukator i madh dhe nga frytet e tij dolën dy famullitarë, njëri u bë meshtar në Firence, kurse tjetri hyri në manastir Certozian. Ishin këto shenjat e një përvujtërie e përkushtimi mistik, të cilat në të ardhmen kishës do t’ia dhuronin një njeri të shenjtë. në pjesën e dytë “Një zemër e përflakur”përshkruhet vizita e Filipit që i bënte Kata-



“ Është ky një libër, i cili lexuesit i ofron mundësinë për t’u njohur me figurën, personalitetin, butësinë, dashurinë, mirësinë, profecinë dhe shenjtërinë e këtij biri të kishës, i cili tërë jetën e tij ja përkushtoi fesë dhe dashurisë ndaj njeriut dhe Zotit. ”

kombeve të Shën Sebastianit dhe akti mrekullibërës që i kishte ndodhur atij, gjersa ai po i lutej në gjendje kontemplative shpirtit të shenjtë. Më pas Shën Filipi na del si një vetmitar, i cili bredh rrugëve të Romes duke soditur brengat dhe jetën e këtij qyteti. Më pas ai viziton jo pa shkas të shtate kishat më të njohura të asaj kohe dhe spitalet duke i ndihmuar të sëmurit në trup dhe shpirt. Më pas Shën Filipi fillon të ungjillëzojë njerëzit edhe nëpër rrugë, edhe pse nuk kursehej kurrë nga sharjet dhe injoranca nga të tjerët. I etur për dashuri ndaj njerëzve në nevojë, ai bëhet anëtar i „vëllazërisë së trinisë së shenjtë “ku se bashku me priftin ndihmon shtegtarët dhe të sëmurët e Romes. Në pjesën e tretë “Filipi meshtar në Romë” përshkruhet shugurimi i tij në Romë nga monsinjor Giovanni Lunellio dhe angazhimet e tij shpirtëror për t’i bindur të tjerët në besim e përkushtim. Nga e gjithë kjo në shesh na del një orator i çmueshëm, i cili

pas vetes tërheq shumë ithtarë e kureshtarë . Nga përvojat e kontakteve Filip Neri na del edhe si një rrëfëstar i dalluar, ku pas përvojave të frytshme dhe takimeve me njerëz të ndryshëm, del si një ungjillëzues i vërtetë. Atij nuk i mungojnë edhe situatat e vështira dhe injorimi e shpifjet nga sivëllezërit e tij, por mbi të gjitha ky njeri i shenjtë zgjedh durimin, i cili më në fund ngadhënjën mbi injorancën dhe egoizmin e tyre. Në pjesën e katërt “aftësia kundër mëkatit”. na del në pah koncepti shpirtëror i Filip Nerit, i cili ishte kundër lavdisë së kotë, mospendesës së mëkatarëve, kotësisë, e shumë veseve tjera njerëzore. Ai i ofronte dhe i çmonte metodat origjinale të përvujtërisë , dhe e preferon përvujtërinë e jetuar, të shoqëruar edhe me dhembje. Ai ngritet kundër mëkatit të grykësisë dhe pasurimit të tepruar të kësaj bote. Në pjesën e pestë të librit “Një dritë për qytetin e amshuar” përshkruhet jeta dekadente në Romë dhe angazhimi i Shën Filipit për ta zbutur papunësinë, lakuriqësinë, varfërinë dhe cubninë që e kishte kapluar qytetin e amshuar. Këtu përshkruhet edhe dëshira e tij e madhe për ta vizituar Indinë, e cila vizitë u ndërpre me sugjerimin e këshilltarit të tij të përvuajtur Agostino Ghattini dhe i cili i paralajmëron për rreziqet që mund ta shoqëronin Filipin e SHENJET. Në këtë pjesë jepen të dhëna për një veçanti të tij, siç ishte prirja për profeci e Shën Filipit dhe refuzimi i tij për ta pranuar postin e Kardinalit, pasi që ai ishte përkushtuar - përcaktuar për jetën e meshtarit të varfër dhe të thjeshtë. Jeta dhe qëllimi i tij ishte shërbesa e jo posti e pushteti. I njëjti veprim kishte ndodhur edhe me rastin e refuzimit të tij për ta marrë pozitën e Papës. Pjesa e gjashtë “Lutjet e Shën Filip Nerit” përshkruhen disa copëza përshpirtërie të shenjtit, të cilat ai ia kishte drejtuar Zotit gjatë lutjeve të tij të përthelluara. Shën Filipi kishte etje për shërbesë ndaj qiellit e jo etje për pushtet të tokës. Këtë e dëshmoi jeta e tij deri sa kaloi në amshim në agun e 26 Majit të vitit 1595 mu në ditën e festes se “Corpus Domini”. Dhe krejt në fund një falënderim iu takon përkthyesve të këtij libri Don Pal Tunajt dhe don Jeton Thaqin të cilët na mundësuan që Shën Filip Nerin të na sjellin në gjuhën shqipe, jo vetëm për ta lexuar biografinë e tij, por për ta kuptuar më thellësisht shenjtërinë e këtij shenjt.

Recension

## Libër i veçantë për luftëra e dëshmorë të veçantë

*Afrim Mustafa, “ Bardhësitë e Atdheut” – Monografi për 2.073 dëshmorë të tri ushtrive çlirimtare: UÇK në Kosovë, UÇPMB në Kosovën Lindore dhe UÇK në Maqedoni , Botoi Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së Prishtinë dhe Radio “Zëri i SHARRIT” Kaçanik – Ferizaj, mars , 2008*

■ SHKRUAN:  
**Gjeneralmajor Shukri BUJA**

Javë më parë lexuesve kosovarë, por jo vetëm atyre, u ka rënë në dorë një libër i vlerave të veçanta, veçanti, të cilat do t’i përfetojnë që në hapjen e tij. Fillimisht, në “Bardhësitë e Atdheut” me autor veteranin e UÇK-së, Afrim Mustafa, do të përballemi me Betimin e Ushtarit, që paralajmëron se libri nuk është libër i përmasave të kufijve administrativë dhe i respektimit të pjesshëm të betimit ushtarak të Kosovës, por respekton me përpikëri betimin ushtarak. Libri në vete ngërthen betimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili është i qartë: Luftë për çlirimin e tokave të pushtuara të Shqipërisë dhe Bashkimit e tyre. Gjatë tërë librit lexuesi do të përballët me biografitë e ushtarëve të lirisë të luftërave të fundit, pavarësisht se në kohë dhe rrethana të ndryshme dhe pavarësisht se me pushtues të ndryshëm, ata kanë një qëllim dhe një ideal: çlirimin e tokave të pushtuara të Shqipërisë. Libri që është ndërtuar qëllimshëm në bazë të renditjes alfabetike të dëshmorëve, tregon se autori i ka pasur parasysh madhështitë e dëshmorëve dhe nuk ka pasur mundësi që t’i radhisë ndryshe dëshmorët. Dhe kjo renditje thyhet me qëllim dhe e cila, duket se nuk i shkon librit në kapituj të veçantë të dëshmorëve të veçantë të luftërave të veçanta. Por, kjo thyerje nuk ia zbeh, por vetëm se ia shton madhësitë këtij libri, sepse vetëm se thyen monotoninë. Por, gjithsesi libri ka renditje të qartë të luftërave çlirimtare, të cilat kishin një qëllim: pra, radhitja e këtyre është, jo qëllim i ndarjes, por për shkak të qëllimit të luftës, i cili ishte i njëjtë, pra çlirimi i tokave të pushtuara të Shqipërisë. Autori, duke dashur të freskojë librin, në kapitullin, “Artikuj të botuar gjatë luftës “, e fillon me një poezi të veçantë, “Këngë nga maja e Sharrit” , për të vazhduar me raportet e autorit nga vendi i ngjarjes në luftë, që tregojnë edhe për ikjet nga dhuna serbe, që dikush i quan eksode biblike. Këtu madje, është edhe shkrimi, “Ah, këta prishtinalitë”, si një sarkazëm, kur në Kosovë gjakderdhja ishte e madhe në kohën kur ushtarët po binin dëshmorë, kishte edhe të atillë, të cilët edhe në atë kohë kërkonin kushte për dëfrim. Dhe me këtë autori tregon edhe faqen tjetër të asaj kohe.

### Monografi e përmasave kombëtare shqiptare

Librit ia shtojnë vlerën edhe intervistat e botuara në kohën e luftës, si me Adem Demaçin, që ishte përfaqësues politik i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së , ashtu edhe me komandant Bardhin-Qamil Ilazi. Po ashtu, libri është plotësuar në vazhdim edhe me shumë informata, raporte e raportime të drejtpërdrejta të autorit nga disa vatra të luftës nga vendi i ngjarjes. Rënditja profesionale e librit pasqyron tragjizmin, shpresën, heroizmin dhe lavdinë, të cilat, gjithsesi ishin vetë lufta dhe luftëtarët e lirisë. Në faqet e fundit autori do të plotësojë librin me fotot e dëshmorëve, fillimisht me fotografi të dëshmorëve të Kaçanikut dhe të Ferizajt, si një tregues se, autori është i kësaj treve, se autori gjatë luftës bashkëvepronte dhe bashkëndjente me ta. Si një tregues i veprimit dhe i angazhimit të tij atdhetar, për, dhe në këto treva. Ai duket sikur ri sharron në përshlytjen se autori është lokalist, por gjithsesi ngritet duke shfletuar librin dhe shohim se ai arrin në piedestalin më të lartë me fotografi të kryekomandanti legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, Fehmi e Xhevë Lladrovci, Tahir Sinani e Ismet Jashari, për ta përmbyllur kapitullin e fotografive me masakrën e Stagovës, vendlindja e komandant Zefit- Agim Bajrami. Madhësitë këtij libri, gjithsesi ia shtojnë emrat e njohur si, Fatmir Limaj, Jakup Krasniqi, Fazli Veliu, të cilat autori i ka recensentë. Por, edhe ekipi këshilldhënës, si Rexhep Selimi, Gani Krasniqi, Ahmet Isufi e shumë të tjerë. Në fund, dua të përgëzoj z. Mustafa që na mësoi që në duar të kemi një libër të vecantë që në vetvete ka emrat e luftërave tona çlirimtare, ashtu siç ishte edhe qëllimi ynë në betim, ashtu siç ishte edhe vetë ideali i të rënëve. Uroj autorin shëndet e botime të reja !

*(Autori i këtij recensionit, Shukri Buja, aktualisht është kryetar i komunitetit të Lypianit, gjatë luftës ishte komandant i Zonës Operative të Nerodimes.*

*Ai është redaktor në monografinë, “Bardhësitë e Atdheut” të autorit Afrim Mustafa).*



Figura biblike

# Maria Magdalenë

■ SHKRUAN:  
M. Ollga DULAJ

Jemi në kohën e Pashkëve, ku ndër figura tjera, takohemi edhe me një personazh, Marinë Magdalenë. Sapo e dëgjojmë këtë emër, na shkon mendja se Jezu Krishti kishte dëbuar prej saj shtatë djaj, e në anën tjetër kjo është e njëjta që i shkon te varri dhe sheh se Jezu Krishti nuk gjendet aty. Kush është kjo grua? Them „është“ sepse ajo jeton në Zotin, është shenjtëreshë, në kalendarin liturgjik përkujtohet me 22 korrik.

Nga breviari, në përkujtimin e kësaj shenjtëreshe thuhet krejt shkurt ajo qenësorja: „Ishte e pranuar në mesin e apostujve. Ka qenë e pranishme te vdekja e tij /Jezusit/ dhe për Pashkë shumë herët e ka parë Shëlbuesin i cili është ngjallur prej së vdekuri. Nderimi ndaj saj në Kishë është përhapur në mënyrë të veçantë në shekullin XII“.

Jeta e Maria Magdalenës para se të jetë pranuar në mesin e nxënësve të Jezu Krishtit, është shumë diskutabile në mesin e atyre që shpjegojnë Shkrimin Shenjt, etërve të shenjtë dhe hagiografëve. Kanë mendime të ndryshme. Në shekullin e mesëm ka qenë shumë e theksuar se kjo ka qenë një mëkatore e madhe dhe se është kthyer kah Zoti dhe është bërë një pendestare e madhe: prezantuese e shkëlqyeshme e të gjithë atyre që janë kthyer.

Emri i saj Maria Magdalenë, vjen nga vendi Magdala në liqenin e Gjenezaretit.

Maria është nga fisi bujar, mbretëror. Babai i saj quhej Syros, kurse nëna Eucharia. Kanë pasur pasuri të madhe. Maria e mori emrin Magdalena, sipas pasurisë familjare Magdalum, sepse pas vdekjes së babait të saj, që të tre trashëgimtarët kishin ndarë pasurinë: Maria mori Magdalen, vëllai i saj Lazri pjesën e Jeruzalemit, kurse Marta Betaninë.

Ungjilli flet mbi Marinë Magdalenë se Jezusi kishte dëbuar prej saj shtatë djaj (Lk 8, 2). Kjo e dhënë, megjithatë, nuk çon në atë se Maria Magdalenë ka qenë mëkatore. Disa e shpjegojnë këtë se Jezusi e kishte liruar atë nga ndonjë sëmundje psikike, ndonjë depresioni a të ngjashme. Por, ekziston bindja se ajo ishte një mëkatore dhe në bazë të kësaj bindjeje, shfaqen shumë filma, pikturohen figura, e vepra tjera artistike, ku kjo grua paraqitet me flokë të gjata dhe të lëshuar, me supe të zbuluara, që aludon në mëkatin kundër urdhrat të gjatë, e shtatë djajtë janë një

rast i mirë për ta paraqitur atë si mëkatnore.

Si është e mundur që Maria Magdalenë të njihet si një mëkatnore publike, e njëherësh si nxënëse e Jezu Krishtit?

Këtë grua në Ungjill e gjejmë në situata të ndryshme.

Kjo ishte një mëkatnore, por të cilës nuk i përmendet emri. Ajo, kur kishte dëgjuar se Jezusi ishte te një farize, me emër Simon, i cili e kishte thirrur Jezusin për bukë, mori një enë alabastrit me parfum, zuri vend pas tij, tek këmbët e tij dhe duke qarë, filloi t'ia lajë këmbët me lot, t'ia fshijë me flokë, t'ia puthë e t'ia lyejë me parfum. E kur Simoni /farizeu/, duke ditur se kjo ishte një mëkatnore, në mendjen tij, kishte dyshimin e tij se Jezusi është profet, përndryshe, sipas tij, Jezusi do ta dinte se kjo është një mëkatnore e njohur. Farizeu në vetvete e akuzon Jezusin dhe mëkatnoren. Ndërsa, Jezusi, pas një lekcioni të bukur që i mbajti farizeut, i tha: „Ju falën mëkatet e shumta, sepse tregoi dashuri të madhe. Ai, të cilit i falen pak, më pak dashuri tregon“. Atëherë i tha gruas: „Të janë falur mëkatet!“ (krh. Lk 7, 36-48). Ndërkaq, farizeu u gjet i papërgatitur, sepse iu zbuluan mendimet. E mëkatnoria gjithë kohën heshte.

Në Betani, tek Lazri miku i tij, gjashtë ditë para Pashkëve derisa Marta u shërbente, Maria ia lyen këmbët Jezusit dhe ia fshin me flokët e saj. E në reagimin e Judë Iskariotit, se gjoja u bë harxhim dhe këtë do ta kishin mundur ta shfrytëzojnë për skamnorë, Jezusi thotë: „Lëre! Le ta bëjë këtë për ditën e varrimit tim“ (krh. Gjn 12, 1-7). Në këtë rast, Mateu as Marku nuk ia përmendin emrin fare (krh. Mt 26, 7; Mk 14, 3).

Kjo grua mëkatnore është figurë e Kishës, e cila rrahët në gjoks dhe rrëfen mëkatin e saj. Kjo është po ashtu Kisha – e lumtur e cila guxon të merr pjesë në gostinë në të cilën është vet Jezu Krishti, me Trup dhe Gjak. E pranon faljen e tij pa kurrfarë kompromisi, falas.

Luka, ungjilltar, na sjell edhe qëndrimin e Marisë tek këmbët e Jezusit, duke e dëgjuar, ku e lëvdon Jezusi se ajo zgjodhi pjesën më të mirë, që nuk do t'i merret (krh. Lk 11, 38-42).

Maria Magdalenë, ishte ndër gratë, që kishin qenë shëruar nga shpirtrat e ndytë e sëmundjet: Maria e quajtur Magdalenë, prej së cilës kishte dëbuar shtatë djaj/të cilat, bashkë me të Dymbëdhjetët e përcillnin Jezusin në predikimet dhe janë dëshmitare të mrekullive dhe shërimeve që ai bënte (krh. Lk 8, 1-3). Ajo ishte

e pranishme edhe nën Kryq, si nxënëse besnike dhe shembull për të gjithë ata që shkojnë pas Jezusit.

Kurse kulminacioni i paraqitjes së kësaj figure të madhe biblike, është takimi i saj me varrin e zbrazët të Jezusit, gjegjësisht me ngjalljen e Jezu Krishtit, si na e përshkruan në mënyrë të mrekullueshme Gjoni ungjilltar:

„Ditën e parë të javës, në mëngjes, pa dalë drita, erdhi Maria Magdalenë te varri dhe pa se guri ishte hequr prej varrit. Atëherë, erdhi me vrap, te Simon –Pjetri dhe tek ai nxënësi tjetër, të cilin Jezusi e donte dhe u tha: „e kanë marrë Zotërinë prej varrit dhe nuk dimë se ku e kanë vënë“. (Gjn 20, 1-2). Për t'u thelluar kjo përvojë edhe më shumë me Jezusin tashmë të ngjallur, ai i dëftohet asaj: „Maria qëndroi jashtë të varrit dhe qante. Ashtu, duke qarë, u përkul, e shikoi në varr. Pa dy engjëj të veshur me petka të bardha ndenjor në atë vend, ku që trupi i Jezusit – njëri te koka e tjetri te këmbët. Ata i thanë: „Pse po qan, moj burneshë? Ajo u përgjigj: „E morën Zotërinë tim e nuk e di se ku e vunë“. Si tha kështu, u soll prapa dhe e pa Jezusin në këmbë, por nuk dinte se ishte Jezusi. Jezusi i tha: „Pse po qan, moj fisnike? Kë po kërkon? Ajo, duke kujtuar se është kopshtari, i tha: „Zotëri, nëse e ke marrë ti, më trego ku e vure e tani po e marr unë“. „Mari!“ – i tha Jezusi. Ajo u kthye e i tha hebraisht: Rabbuni!“ (që do të thotë mësues). Jezusi i tha: „Mos u ngarrit me mua, se ende nuk u ngjita tek Ati, por shko te vëllezërit e mi e thuaju: Po ngitem tek Ati im e Ati juaj, tek Hyji im e Hyji juaj“. Maria Magdalenë shko i dhe u lajmëroi nxënësve se e pa Zotërinë dhe se i tha këto fjalë.“ (Gjn 20, 11-18).

Kjo grua, në jetën e të cilës kishte ndërhy Jezu Krishti dhe që si përgjigje ndaj këtij hiri të Zotit, këtë grua e gjejmë pothuajse gjithmonë duke qarë para Jezusit, të përkulur para tij, të dëgjueshme ndaj tij, krah për krah me të Dymbëdhjetët – edhe ajo dëshmitare, e kështu edhe në ngjalljen e Zotërisë. Kjo shenjtëreshë sot është shembull e gruas së sjell Lajmin e Mire, model i një ungjillëzuese e dëshmitareje e cila e gjithmonë e takoi Mësuesin me dashuri, me ndjenja e gjeste pendimi, përvujtërie e përkuljeje. Me guximin e saj tejkalon opinionin dhe mentalitetin njerëzor – tokësor, me qëndrueshmëri e ndjek Mësuesin kah do shkon dhe mësimin e tij, për të qenë dëshmitare, për çka Ai vet e bëri të denjë me faljen e



mëkateve që i dha.

Ngjarja tek varri i Zotërisë dhe dëftimi i tij, në këto ditë kur po kremtojmë misterin e Pashkëve, na mbushin me frymëzime të reja për ta kërkuar të Gjallin, por jo ndër të vdekur, por ndër të gjallë.

Me pyetjen që Zotëria i bën: “Pse po qan moj fisnike” dhe “kë kërkon?”, dëshiron të zbulojë tashmë arsyen e lotëve dhe të kërimit të saj. E në të vërtetë, i Ngjalluri, edhe ne na bën këtë pyetje. Askush nuk ka arsye të jetë i pikëlluar, sepse Jezusi me ngjalljen e tij, na dhuron një jetë të re, e hiri më i madh është se Ai vet është me ne. Prandaj, edhe në kërkimet tona jetësore është Ai vet – i Ngjalluri është me ne dhe nëse e gjejmë dhe e përnjohim, kemi gjetur lumturinë, të vërtetën. Atëherë e kërkojmë edhe më tepër, e kërkojmë pa pushim. Po i Ngjalluri dëshiron të dijë prej nesh, të jemi që qartë e të arsyeshëm se kë kërkojmë dhe pse e kërkojmë. Kur e kërkojmë Jezu Krishtin, Ai na dëftohet në mënyra të ndryshme, në situata të ndryshme. Po që ta përnjohim është e nevojshme të ecim me të, ta përcjellim vazhdimisht mësimin e tij, të qëndrojmë tek këmbët e tij sepse kjo është pjesa më e mirë, që duhet zgjedhur e që nuk do të na merret. T’i kundrojmë veprat e tija të mrekullueshme që çdo ditë i bën ndër sy tanë, ta duam shumë sepse kemi nevojë shumë për faljen e tij. Ta njohim atë gjatë jetës sonë deri në vuajtje, deri në vdekje, sepse Ai na njeh ne në dashuri dhe vuan për ne, e jep jetën për ne. Ta kërkojmë të qëndrueshëm në dashuri, në vepra të mira e me zemër të pastër, dhe atëherë do ta

shohim Zotin (krh. Mt 5, 8).

Kur Jezusi i thotë: Mari! Ajo e njeh vetveten në Krishtin, e njeh se është një pjesë e Tij dhe se Ai ishte bërë jeta e saj. Në Bibël, ta thërrasësh dikë me emër, dmth ta njohësh /në kuptimin ekzistencial/ me dashuri dhe ka rëndësi të veçantë në jetë, në mënyrë të ndërsjellë. E reagimi i saj është: “Rabbuni!” që dmth. “Mësues”.

Kush mund ta marrë me mend gëzimin e Marisë Magdalenë, në momentin kur ajo e njeh Mësuesin dhe Zotërinë në të thirrur të emrit të vet. Në veten e saj, e përnjohu Jezusin, sepse kishte qëndruar me Të gjatë jetës tokësore.

Në këto ditë kur po e kremtojmë Ngjalljen e Jezu Krishtit, jemi të thirrur që këtë ngjarje, duke e kremtuar, ta përjet(s)ojmë duke e shikuar varrin e zbrazët të Jezusit, duke e kërkuar të Ngjallurin, para së gjithash në brendësinë tonë, në jetën tonë. Me këtë gëzim pashkëvor, që është burim i çdo gëzimi, me Marinë Magdalenë të kumtojmë:

*Na trego, ti o Mari,  
Çka ke parë me ata sy?  
Kam parë varrin e Krishtit të gjallë  
Dhe Lavdinë e atij që u ngjall*

*I pashë engjëjt dëshmitarë,  
Rizën, petkat t' vëna palë.  
U ngjall Krishti e imja shpresë,  
Para u del n' rreth t' Galileë.*

*U ngjall Krishti përnjëmend!  
Mbret, fitues – mëshirë për  
gjithkënd.  
Amen. Aleluja*

(Nga Ndjekësorja e Pashkëve)



# Si sillemi me konfliktin bashkëshortor?

■ SHKRUAN:  
Dr. Pavao BRAJSA

Është shumë me rëndësi për të dalluar sjelljen kundrejt konfliktit bashkëshortor nga zgjidhja e tij. Shumë konflikte bashkëshortore janë të pazgjidhura, sepse janë shkaktuar nga probleme që çiftet bashkëshortore nuk janë në gjendje t'i shmangin, që nuk janë në gjendje t'i zgjidhin. Nëse kjo është e vërtetë, unë jam i bindur se është, atëherë sjellja kundrejt konflikteve, që në të vërtetë i përgjigjet asaj që e quajmë grindje (zënkë), është shumë më e rëndësishme sesa vetë zgjidhja e saj.

Qysh këtu mund të theksojmë që pikërisht ky fakt i ekzistimit të problemeve të pazgjidhura në sjelljen/veprimin e çifteve martesore imponon nevojën e ekzistimit të grindjes si pjesë përbërëse e jetës së përditshme dhe reale në martesë. Logjikisht nga kjo rrjedh që të paktën po aq me rëndësi, nëse jo edhe më me rëndësi, është që të mësohesh të grindesh në mënyrë humane dhe të ndershme sesa t'i zgjidhësh problemet ndërmjerëzore.

Martesa pa konflikte bashkëshortore gati është e pa imagjinueshme. Shtypja e konflikteve bashkëshortore është më e dëmshme se sa e dobishme. Zgjidhja e tyre në shumë raste gati është e pamundur. Për këtë arsye, nëse çiftet martesore dëshirojnë të jetojnë në martesë në mënyrë cilësore, nevojitet të mësohen edhe të grinden cilësisht, d.m.th. në mënyrë cilësore humane të sillen me konflikte bashkëshortore. Çdo sjellje jo-cilësore kundrejt konflikteve bashkëshortore e bën grindjen vijuese bashkëshortore edhe më të vështirë. Me kohë ndër partnerët bashkëshortorë mblihet gjithnjë e më shumë material konflikti me një gatishmëri gjithnjë e më të theksuar të njërit dhe tjetrit çift martesor për grindje të re dhe gjithnjë e më të ashpër.

Konflikti bashkëshortor mund të jetë i mbuluar dhe evident. Është me rëndësi të dallosh problemet e njëmendë që kanë çuar deri te ai nga vështirësitë, interpretimet dhe përjetimet emocionale subjektive të konfliktit të atyre që në të marrin pjesë. Po ashtu duhet dalluar sjelljen kundrejt konfliktit nga zgjidhja e konfliktit. Sjelljen kundrejt konfliktit brenda martesës e quajmë grindje bashkëshortore.

A ekzistojnë konflikte në martesën time? A i shtyp, i mbuloj dhe i mohoj, apo ballafaqohem me to? A jam në gjendje ta dalloj në mënyrë të njëmendë dhe objektive, atë çfarë ka çuar deri te to nga ajo subjektive, personale dhe emocional në sjelljen time kundrejt tyre? A jam i gatshëm



“ Grindja bashkëshortore mund të jetë e njëmend apo imagjinare. E para bazohet në fakte të njëmenda kurse e dyta në arsyet me gjasë. E para ka lidhje kurse e dyta nuk ka lidhje me ngjarjet e njëmenda dhe ndodhive në martesë. ”

me partnerin bashkëshortor të bisedoj jo vetëm për zgjidhjen e problemit dhe konfliktit por edhe për sjelljen time dhe të tij kundrejt tij (konfliktit)? A jam i gatshëm të bisedoj me partnerin për mënyrën e grindjes sonë të përbashkët?

Të gjejmë kohë edhe për bisedim për grindjet në martesën tonë! T'ia parashtrijmë vetes pyetjet e përmendura dhe të provojmë të fitojmë një pasqyrë rreth mënyrës sonë të grindjes!

## Shmangia e konfliktit real bashkëshortor

Në sjelljen tonë me konfliktin martesor shpeshherë e përdorim metodën e shmangies, ikjes nga ballafaqimi direkt me arsyet dhe problemet e njëmendë, d.m.th. me shkaqet e njëmendë të konfliktit të ndërsjellë. Më së shpeshti problemi me brendi i njëmend shndërrohet në një problem të ndërsjellë të marrëdhënies. Shumë shpejt prej problemit për të cilin është fjala dhe me të cilin ka filluar grindja kalohet në fajësim, kundërshtim, shantazhim, presion dhe ofendim të ndërsjellë. Pak nga pak partnerët bashkëshortorë harrojnë për çka kanë filluar të grinden dhe shpejt gjenden në një terren të një qërimi hesapësh të ndërsjellë armiqësor.

Në rastin e dytë njeriu gjen diçka jashtë tij, diçka objektive, si arsye kryesore e konfliktit. Edhe kjo është një formë e keqpërdorimit të fakteve të njëmendë, që kurrë nuk do të bëheshin arsye konfliktesh po të mos kinin nevojë partnerët bashkëshortorë

për to në mënyrë që ta shmangin takimin direkt me marrëdhënien tonë konfliktive. Gjithmonë është më lehtë të bisedohet dhe të grindet për diçka „të tretë“, për diçka „të njëmendë“ jashtë nesh sesa për diçka në mes nesh.

Në rastin e tretë njeriu e shmang dhe kalon përkaj partnerit të njëmend me të cilin është në konflikt dhe grindet nëpërmjet dikujt të tretë. Nuk jemi në gjendje t'i afrohem atij drejtpërdrejt dhe të flasim me të për konfliktin, kështu që këtë e bëjmë tërthorazi, zakonisht me dikë që për ne është më pak i rrezikshëm, që na kërcënon më pak. Brenda familjeve tona për këtë gjë shërbejnë shkëlqyeshëm fëmijët, dhe në këtë mënyrë konfliktet nga vendi i punës mbarten edhe në martesë. Më lehtë është ta shaj gruan sesa drejtuesin në vendin e punës! Shoqërisht është më e pranueshme „me qëllim për ta edukuar“ t'i mësohet shpullë fëmijës sesa gruas. Ky është keqpërdorim i më të dobët dhe më të arritshmit në llogari të më të fortit dhe të më të rrezikshmit, më vështirë të arritshmit.

Në rastin e katërt shmanget dhe kalohet tërthorazi ballafaqimi direkt me problemin e njëmendë që është eventualisht më vështirë i zgjidhshëm apo me të cilin për çfarëdo arsye njeriu nuk dëshiron të ballafaqohet, kështu që thjesht zëvendësohet me një tjetër me tahmin, të parëndësishëm, sekondar - që e kam afër dorës. Nëse i shikojmë nga një distancë shumë konflikte dhe grindje bashkëshortore atëherë na bëhet qesharake kur fillojmë

të mendojmë për cilat krejt arsye grinden partnerët. Vështirë është të besosh që ato janë arsye e njëmendë të grindjeve, sidomos nëse e kemi para sysh rrjedhën dhe zhvillimin e tyre, pasojat dhe gjithë atë deri ku ato çojnë. Zakonisht përfundojmë që kjo nuk mund të jetë arsyeja e tyre e njëmendë.

Në bazë të katër mënyrave të përshkruara të ikjes nga konflikti i njëmendë domosdo vihet deri te bindja që në shumë raste thjesht grindemi „gabim“, se shpesh jemi Don Kishota që luftojnë me mulirin e erës. Atëherë grindjet tona janë të pushtuara me iluzione fantazirash që na pamundësojnë që të takohemi me problemet e njëmendë dhe me partnerë të njëmendë.

## Shtatë elemente bazike të grindjes bashkëshortore

Sipas librit „Armiqetë intime“, shumë të popullarizuar në Amerikë, që e kanë shkruar G.R. Bach dhe P. Wyden, grindja mund të vështrohet në suaza të nëntë karakteristikave të tyre elementare.

Grindja bashkëshortore mund të jetë e njëmendë apo imagjinare. E para bazohet në fakte të njëmendë kurse e dyta në arsyet me gjasë. E para ka lidhje kurse e dyta nuk ka lidhje me ngjarjet e njëmendë dhe ndodhive në martesë.

Më tutje, mund të jetë e ndershme apo e pandershme, ofenduese apo jo ofenduese, fer dhe jo fer, në të cilën njeriu e respekton apo nuk e respekton atë me të cilin grindet.

Mund të jetë dyanshmërisht aktive apo thjesht pasive. Nuk është krejt njëjtë se a marrin pjesë të dy partnerët barazi apo njëri tërheq kurse tjetri dominon. Mund të flasim edhe për pjesëmarrjen me të drejta të barabarta dhe të pabarabarta të partnerëve bashkëshortorë në grindje.

Grindjen bashkëshortore mund ta vështrojmë edhe nëpër nivelin e përgjegjësisë së pjesëmarrësve të grindjes për atë çfarë ndodh në të. Përgjegjësinë për pjesëmarrje në grindje çiftet bashkëshortore mund ta pranojnë duke i paraqitur mendimet e tyre, flasin në vetën e parë, dhe tregojnë atë çfarë mendojnë, apo këtë përgjegjësi nuk e pranojnë, kështu që paraqesin mendime të huaja, shprehen papërcaktueshëm, vazhdimisht thirren në atë çfarë mendon apo flet dikush apo të tjerët.

Humori gjatë grindjes bashkëshortore mund të jetë jo ofendues dhe relaksues, por mund të jetë edhe ofendues, ironizues. Përqeshja dhe tallja e partnerit bashkëshortor e bën grindjen jocilësore. Në një grindje të tillë partnerët bashkëshortorë nuk ndjehen mirë, e përjetojnë veten të ofenduar.

Grindja bashkëshortore mund të jetë e hapur dhe agresion jo i maskuar, apo agresion i fshehur dhe i maskuar. Më pak dhemb sulmi direkt sesa indirekt në dikë.

Në grindjen bashkëshortore çiftet martesore mund të jenë të qartë, të njëkuptimshëm apo të jo të qartë dhe shumëkuptimshëm, të dëgjojnë edhe porosinë e partnerit apo vetëm të pohojnë me kryeneçësi të veten. Mënyra e komunikimit të ndërsjellë është kryesore për cilësinë e grindjes në martesë.

Grindja bashkëshortore mund të jetë e drejtuar në të tashmen dhe në partnerin e njëmendë, por edhe në të kaluarën dhe në disa partnerë të tjerë. Grindja cilësore bashkëshortore qëndron në atë çfarë ndodh tani dhe përnjëmend në martesë dhe nuk ikën në të kaluarën as nuk e përdor atë çfarë ka ndodhur më përpara për „zgjidhjen“ e asaj çfarë është duke ndodhur tani. Ajo është e lidhur me atë me të cilin grindet.

Dhe në fund, grindja bashkëshortore mund të jetë e drejtpërdrejt apo e tërthortë, e lidhur për një problem të caktuar dhe një sjellje e caktuar të partnerit, apo e lidhur për karakteristikë të përgjithshme dhe të pacaktuara të atij me të cilin partneri bashkëshortor grindet. Grindja cilësore nevojitet të drejtohet në një problem të caktuar dhe sjellje të caktuar, dhe jo që të shkapërdhet në diçka të përgjithshme apo të pacaktuar.

Për çfarë grindje është fjala në martesën tonë?

(Përktheu: P. Shtjefën Dodes SJ)



# “Mësues i mirë, çka duhet të bëj për të fituar Jetën e pasosur?” (Mk 10,17)

■ PËRGATITI:  
Don Jeton THAQI

Një prej takimeve më të rëndësishme që i mbanë Papa (me parë Gjon Pali II e tani Benedikti i XVI) pa dyshim janë takimet rinore që për çdo vit mbahen në nivelin dioqezan dhe për çdo të dytin vit në nivelin botëror. Këto janë momente jashtëzakonisht të rëndësishme për mbarë rininë, e cila bashkohet rreth pasardhësit të Shën Pjetrit për t'u lutur, për të medituar dhe në mënyrë të veçantë për t'i dhënë shpresë botës se Krishti është Rrugja, e Vërteta dhe Jeta. Këto takime, përveç tjerash, janë të një rëndësie të veçantë, me qen se marrin pjesë shtresa më e mirë dhe më vitale e shoqërisë, pra rinia. Rininë papa Gjon Pali i II, në vigjiljen e lutjes, me rastin e 2000-vjetorit të krishterimit në takimet botërore të rinisë, që u mbajt në Tor Vergata (Romë) i quajti “*ijtë e agimit*”: “*Të dashur miq, shoh në ju “ijtë e agimit” (krh Is 21,11-12) në këtë fillim të mileniumit të tretë. Gjatë shekullit që tani po mbaron, të rinjtë si ju mblidheshin për t'u mësuar se si të urrejnë, dërgoheshin në luftë për të luftuar kundër njëri-tjetrit. Kishim shumë mesianizma të shekullarizimit që kanë tentuar në çdo mënyrë të zëvendësojnë shpresën e krishterë, dhe që pastaj janë manifestuar ferr i vërtet. Sot jeni këtu që të përcaktoheni që në të ardhmen ju nuk do të bëheni instrument i dhunës, i shkatërrimit; do ta mbronin pagën, duke e paguar, nëse është e nevojshme edhe me jetën tuaj. Ju nuk do të pajtoheni kurrë më këtë botë ku njerëzit vdesin nga uria, mbesin analfabet, ju mungon puna. Ju do ta mbronin jetën në çdo moment të zhvillimit të saj tokësor, do të mundoheni me të gjitha energjitë tuaja ta bëni me të banueshme këtë tokë për të gjithë”* (Romë, Tor Vergata, 19 gusht 2000).

Sa është sot e nevojshme për rininë që këto fjalë të Gjon Palit II të hyjnë në zemrën, mendjen dhe të pushtojnë tërë qenien e tyre. Sa ka indiferencë sot në rininë tonë? Sa mungon solidariteti për vëllezërit dhe motrat që vuajnë dhe pësojnë padrejtësi? Sa ka nevojë sot për rininë që ta mbrojë jetën në çdo hap të zh-

villimi të saj? Shpesh herë jeta rrezikohet me pa mëshirë prej drogës, alkoolit, shfrytëzimeve të ndryshme dhe keqpërdorimit të trupit të njeriut vetëm për sadsfaksionin e epsheve personale, duke e shndërruar kështu personin prej subjektit në objekt. Rrezikohet nga vetë të rinjtë: mendoni sa abortet kryhen prej mjekëve tanë, nëpër spitale tona me kërkesë të vetë vajzave dhe dashnorëve apo bashkëshortëve të tyre duke i mbytur më të pafajshmit, më të pambrojturit. Pastaj jeta jonë ka nevojë të mbrohet nga mjetet e informimit qofshin ato pamoredëgjimore apo ato të shkruara. Prandaj ftesa e Papës e thënë para dhjetë vjetësh është me se aktuale për rininë e Ipeshkvisë sonë, por edhe të mbarë shoqërisë sonë kosovare.

Në vitin 2010 e përkatësisht më 28 mars do të jetë dita XXV me radhë e rinisë, e cila do të mbahet në nivelin dioqezan me temën: “Mësues i mirë, çka duhet të bëj për të fituar Jetën e pasosur?” (Mk 10,17). Është kjo pyetje e cila i drejtohet Jezusit nga një djalosh i ri që ka për synim jetën e pasosur, mbretërinë e Hyjit.

“*Çdo gjë është e mundur për Hyjin*”, ju përgjigjet kështu Jezusi dishepujve, kur ata madje e kuptojnë se askush nuk mund të shpëtohet vetvetiu. Por të pranosh këtë pamundësi është parimi i parë i shpëtimit. Të konstatosh humbjen tënde është kushti i nevojshëm për pranuar se Zoti vetëm Ai shpëton. Çdo gjë është krijuar për ne, që edhe ne të përdorim sa na nevojitet për të dashur Hyjin dhe vëllezërit. E duam Zotin duke i njohur dhuratat e tija dhe i duam vëllezërit duke i dhuruar dhe bashkëndarë me ta të mirat e Zotit.

Por mëkati e ka vendos në ne brengën e posedimit. Gjërat e kanë marrë vendin e Hyjit. Frika për vdekjen na shtynë që të kërkojmë në to përgjigjen, në vend që ta kërkojmë te Zoti. Në fakt gjërat i përgjigjen nevojës që kemi, por jo edhe nevojës që vetë jemi. Mania e të pasurit apo të posedimit e mbyl atë të dhurimit; e ndërron raportin ndërmjet mjeteve dhe qëllimit final.

Ky tregim i djaloshit pas-

anik ndahet në tri skena: e para (Mk 10, 17-22) na paraqet kështu djaloshin, i cili përveç se ka dëshirën ai plotëson edhe të gjitha kushtet për të hyrë në jetën e pasosur, në përjashtim të një më të rëndësishmes: të duaj Zotin dhe vëllezërit mbi të gjitha gjërat. Takimi me Jezusin ia mundëson të pamundshmen, duke ia mundësuar njohjen e Zotit e duke e liruar nga skllavëria. Jezusi e nis për këtë rrugë, duke i thënë se vetëm Zoti është i mirë, dhe që tani mund të lë çdo gjë dhe të shkojë pas tij. Por lidhja apo varësia me gjërat-pasuritë e bën të verbër. Në alternativën Hyjin apo Mammonën – Pasurinë, ai zgjedh pasurinë. Në fund, në vend të gëzimit të atij që ka gjetur thesarin, ai ka trishtimin e atij që ndihet i humbur.

Pjesa e dytë (Mk 10, 23-27) na paraqet deklaratën e Jezusit për pamundësinë e shpëtimit vetvetiu dhe reagimin e dishepujve. Të gjithë jemi shumë të mëdhenj për të hyrë në mbretërinë e qiellit; jemi praktikisht *deve* që s'janë në gjendje të hyjnë në vrimën e gjilpërës. Nëse e njohim këtë pamundësi na bën atëherë të vegjël. Sa më shumë jemi të pasur, aq me shumë do të bindemi se jemi të varfër për gjërat që vlejnë.

Pjesa e tretë e këtij tregimi (Mk 10, 28-31) na paraqet konstatimin e Pjetrit: “Ja, ne lamë çdo gjë e erdhëm pas teje?” Thirrja dhe fjala e tij i kanë transformuar dishepujt në të varfër dhe të vegjël, duke ja u zbuluar atyre thesarin e paçmueshëm për të cilën ja vlen të lësh çdo gjë. Pra, skena e parë e këtij tregimi mbetet mbi nevojën e shpëtimit, e dyta mbi pamundësinë e shpëtimit vetvetiu dhe treta e mundësisë se shpëtimit nëpërmjet varfërisë që na i hap dyert e jetës.

Të dashur të rinj, Jezusi është Zoti që duhet ta duam më gjithë zemër. Mbretëria qëndron të dashur atë që është bërë vëllai i yni. Nxënësi i vërtetë i Jezu Krishtit është ai i cili në shikimin e tij e ka zbuluar të vetmen të mirë të amshueshme. Kështu që raporti më gjërat shkon sikur ishte në fillim sipas planit hyjnor: i liruar nga idhujtaria, të mirat i jeton si dhuratë, duke i pranuar prej Atit dhe duke i ndarë më të tjerët.

## AKTIVITETE RINORE NËPËR FAMULLITË TONA

### Prizren

Duke dashur që besimtarët e famullisë sonë, e sidomos rinia, të përgatiten sa më mirë për festën e Pashkëve, kemi menduar të zhvillojmë për çdo të premtë të kreshmëve nga një takim shpirtëror. Si fillim jemi takuar me datën 19 Shkurt dhe kemi shikuar një film mbi jetën e një shenjtë të madh që përjetoj varret e Krishtit, Padre Pio nga Pietrelcina. Takimi i radhës ka qenë një Ligjëratë e udhëhequr nga Don Albert Jakaj me temën “Kisha dhe Mass Mediat” e mbajtur më datë 26 shkurt. Në takimin e tretë me radhë të mbajtur më 5 mars kemi zhvilluar lutje dhe adhurim me të Shenjtnueshmin Sakrament të udhëhequr nga Mons. Dodë Gjergji. Pastaj një shtegtim në Kishën e Shndërrimit të KRISHTIT në Kuqishtë të Rugovës më datën 20 mars, ku kemi kremtuar Udhën e Kryqit, pastaj kemi kremtuar Meshën Shenjte dhe jemi kënaqur me natyrën mahnitëse të Krijuesit që neve pikërisht na ka dhuruar ta ruajmë e ta sodisim vazhdimisht. E gjithë kjo përmbillet me disa vizita shpirtërore në disa familje të famullisë dhe me marrjen e Sakramentit të Rrëfimit duke u pajtuar sa më mirë me Atin tonë. Ishin këto aktivitete që në famullinë tonë mblodhën shumë të rinj por edhe të gjeneratave tjera dhe e shtuan në ne gëzimin, entuziazmin për të na shpie tek festa me e lumtur që është festa e Pashkëve.

(Ilir Memaj)

### Gjakovë

Më datë 6 mars 2010 në famullinë e Gjakovës u mbajt takimi i vajzave, takim ky që mbahet gjashtë herë në vit. Tema e takimit ishte Viti Meshtarak. Ligjëruese ka qenë m. Zoja Komani. Në këtë takim kanë marrë pjesë 68 vajza nga Gjakova dhe Prishtina, si dhe Kandidatat. Tema ka qenë shumë atraktive, marrë nga libri i Shën Gjon Vianney. Nga ky takim shumëçka i tërheq vajzat e pranishme, por në veçanti ato i befasoi shembulli i këtij shenjtë se si mund të qëndrojnë para Zotit në heshtje-qetësi, ashtu si ka pohuar vet Shën Gjon Maria Vianney: „Unë shikoi Atë dhe Ai më shikon mua...!” Në pyetjen:- A do të doja që vëllai im të bëhet meshtar? Përgjigja për JO ka qenë e nëntë vajzave, kurse për PO ishin 59 vajza tjera. Pas ligjëratës dhe bashkëbisedimeve apo debateve, përkatësisht punës grupore, ka qenë Mesha Shenjte, dhe para Meshës vajzat e kanë tërhequr nga një letër në të cilën shkruante emri i një meshtarit, për të cilin ato do të luteshin gjatë tërë vitit. Pas drekës bëmë edhe një orë rekreacioni. Ky takim ishte vërtetë një oazë shpirtërore. Mirë u pafshim në takimet e radhës!

(m. Simona Nikollbibaj)

### Zllakuqan

Më datë 20 shkurt të vitit 2010 në famullinë e Zllakuqanit është mbajtur takimi i grupit “rinia mariane e Shën Vinqenc de Paulit”. Në Kosovë dhe Shqipëri koordinatorë e këtij rrjeti është Motra Valentina Ramaj. Për shkaqe objektive të udhëtimit rinia nga Shqipëria, saktësisht nga Shkodra dhe Rrësheni nuk kanë mundur të marrin pjesë në këtë takim. Të pranishëm në takim kanë qenë RMV-Prishtinë, RMV-Gillogjan, RMV-Pejë dhe RMV-Klinë se bashku me nikoqirin RMV-Zllakuqan.

Takimi kishte këtë agjendë: ligjëratën e mbajti Patër Luigji i cili kishte udhëtuar nga Shkodra enkas për këtë takim dhe me të përfunduar është kthyer për Shqipëri. Temë e ligjëratës ka qenë jeta dhe veprimtaria e Etërve Vinqencian dhe Shën Luizës Labure. RMV nga Prishtina numëron rreth 20 anëtar kryesisht student dhe të tjerë nga mosha 16 deri 25 vjeç.

Gjithsejtë të pranishëm në takim ishin mbi 100 të rinj nga pesë qendrat e rmv-se në Kosovë. Pas ligjëratës ka qenë mesha e drejtuar nga don Robert Jakaj pasi patër Luigji udhëtoi menjëherë, pas meshës një drekë modeste e mundësuar nga kontributi i rinisë të cilët kishin sjell me veti gjëra ushqimore të përgatitura enkas për këtë rast. RMV në Prishtinë ndër shumë aktivitete që zhvillojnë ajo ka kujdesin edhe ndaj të varfërve, vizitat e të sëmurëve, takimet e rregullta çdo të enjte, përgatitjen e punë dore përmes të cilave sigurojnë një fond modest.

(Luz Balaj)



# Domethënia e simboleve të Pashkëve

*Të dashur fëmijë, në pjesëmarrjen tuaj në meshën e natës së vigjiljes së Pashkëve sigurisht se ka parë disa simbole, të cilat zënë një vend të veçantë në Meshën shenjte, dhe do të kesh pyetur vetveten: pse ndizet dhe bekohet zjarri në oborr të Kishës? Pse përdoret dhe ndizet një qiri jashtëzakonisht i madh? Pse bekohet uji dhe stërpikemi të gjithë me të?*

*Në pika shumë të shkurta do të mundohemi për të dhënë një shpjegim, në mënyrë që kur të shkon në Meshë dhe të shihni këto simbole, të keni një njohuri sadopak të vogël në lidhje me këto simbole.*

## Zjarri



Zjarri konsiderohet njëri ndër simbolet kryesore të liturgjisë së krishterë, është shprehja më e madhe e ngadhënjimit të dritës mbi errësirën, e ngrohtësisë mbi ftohtësinë, e jetës mbi vdekjen.

Në javën e madhe, pikërisht në të Shtunën e madhe, ky simbol arrin ngritjen më të madhe liturgjike në ritin e bekimit të zjarrit. Në natën e Pashkëve, ky zjarr ndizet përjashta Kishës, dhe rreth tij bashkohen të gjithë besimtarët në krye me meshtarin me qirin të pandezur në dorë dhe nga zjarri i bekuar merret flaka dhe ndizet qiri i Pashkëve, simboli i Krishtit të ringjallur, dhe nga flaka e qiriut të Pashkëve ndizen të gjithë qirinjtë e vegjël, që donë të thotë se nga Krishti i ringjallur të gjithë ne marrim dhe pranojmë jetën – Ringjalljen.

## Qiri



Qiri i Pashkëve është simboli i Jezu Krishtit, drita e vërtetë që shndritë çdo njeri. Ndezja e këtij qiri paraqet ringjalljen e Jezu Krishtit, jetën e re që çdo besimtar e fiton nga Jezu Krishti dhe falë dritës së Tij ne shkë-

putemi nga errësira dhe kalojmë në mbretërinë e engjëjve dhe shenjtërve.

Pas ndezjes së qiriut me zjarrin e ri, bëhet procesioni me qirinjtë të ndezur, në drejtim të Kishës. Ky procesion me besimtarët simbolizon popullin e ri të Zotit që e ndjek Krishtin e ringjallur, dritën e botës.

## Uji



Uji është elementi që mundëson dhe pastron jetën, përmes ujit kryhet apo bëhet sakramenti i pagëzimit.

Nata e Pashkëve në të kaluarën ishte i vetmi moment që gjatë vitit administrohej sakramenti i pagëzimit, ndërsa tashti është Nata në të cilën në mënyrë të veçantë përkujtojmë dhe ripërtërijmë premtimet e pagëzimit, është momenti në të cilin besimtari bëhet pjesë e ringjalljes së Krishtit, që paraqet kalimin nga vdekja në jetë.

## Veza e Pashkëve



Në fakt, veza për formën dhe substancën e saj shumë të veçantë që mbanë në vetvete ka pasur gjithmonë një rol shumë

të rëndësishëm dhe një domethënie të madhe, është definuar si: simboli i jetës, simboli i misterit.

Qysh në kohët e lashta vetë toka ishte konsideruar si dy pjesë të të vetmes vezë të ndarë në dy pjesë, dhe vezët ishin simboli i kthimit të jetës.

Thuhet se edhe grekët, kinezët dhe persianët i shkëmbenin vezët si dhuratë për festat e Pranverës, e njëjta gjë bëhej edhe te egjiptianët, të cilët shkëmbenin mes vete vezët e ngjyrosura si urim për fillimin e 'Vitet të Ri' që atëherë ishte i bazuar në bazë të stinëve të vitit. Vezët konsideroheshin edhe si simboli i frytshmërisë, pothuajse gati si një magji, për arsye të lindjes të një qenie të gjallë nga një subjekt kështu i veçantë, që në atë kohë ishte e pashpjegueshme.

Në kohët e lashta vezët konsideroheshin edhe si subjekte që kishin në vete një fuqi të veçantë dhe ishte praktikë të viheshin nën themelet e shtëpisë për ta ruajtur atë nga çdo e keqe. Është shumë interesante se edhe gratë shtatzëna mbanin afër kraharorit të vetë një vezë dhe kështu zbulonin se a është djalë apo vajzë fëmija që duhet lindur.

Domethëniet e shumta dhe të ndryshme që kishte veza para kohës së re, me ardhjen e krishterimit, veza, bëhet simboli i ringjalljes, pot jo më i natyrës, por i vetë njeriut, i ringjalljes së Jezu Krishtit: sikur një zog del i gjallë nga veza kështu Jezusi del i gjallë nga varri.

Vezët e ngjyrosura me ngjyra të ndryshme paraqesin ngjyrat e pranverës dhe dritën e diellit; ndërsa ato të ngjyrosura me ngjyrë të kuqe simbolizojnë gjakun e Krishtit i cili derdhet dhe dhuron jetën të gjithë atyre që besojnë në të.

Shkëmbimi i vezëve të ngjyrosura, që është praktikë të bëhet në festat e Pashkëve, paraqet gëzimin që na dhuron ringjallja e Jezu Krishtit, gëzim të cilin jemi të ftuar ta bashkëndajmë me të gjithë miqtë dhe dashamirët.

(Përgatiti:  
don Anton Ukaj)

# Bibla ose mobili???



Çka do të bëhej nëse me Biblën tonë do të vepronim sikur me mobilin tonë?

- Do ta kishim gjithmonë në çantë ose në xhep.
- Shumë herë në ditë do t'ia hidhnim sytë.
- Shpejt do të ktheheshim në shtëpi ose në vendin e punës, nëse do ta harronim atje.
- Do ta përdornim për t'i gëzuar miqtë me ndonjë mesazh prej saj.
- Do të silleshim me të sikur nuk mund të jetojmë pa të.
- Do t'ua falnim nga një fëmijëve – për sigurinë e tyre – por edhe që të komunikonim me ta.

Dallimi në mes të Biblës dhe mobilit

- Bibla nuk ka asnjëherë probleme me rrjet.
- Përmes saj e kemi gjithmonë lidhjen e mirë, kudo që të gjendemi.
- Nuk ka nevojë t'i mbushet llogaria, Jezusi i ka paguar të gjitha, bisedat i kemi të pakufizuara, edhe sms-at, kuptohet.
- Nuk ka ndërprerje të befasishme të komunikimit, e bateria është gjithmonë plot.

SOS numrat:

- Nëse je i mërzitur, gjeje Gjonin 14
- Nëse je i shqetësuar, gjeje Psalmin 51
- Nëse je i brengosur, gjeje Mateun 6,19-34
- Nëse je në rrezik, gjeje Psalmin 91
- Nëse të duket që Krijuesi është shumë larg prej teje, gjeje Psalmin 63
- Nëse feja jote duhet të forcohet, gjeje Letrën Hebrejve 11
- Nëse je i vetmuar dhe në detin e frikës, gjeje Psalmin 23
- Nëse mendon se je tepër kritik dhe i pandjenja, gjeje 1 Korintasve 13
- Nëse e kërkon fshehtësinë e lumturisë së vërtetë, gjeje Kolosianëve 3,12-17
- Nëse dëshiron paqë dhe siguri, gjeje Mateun 11,25-30



(Përgatiti: M. Teuta Augustini)



Gjithë juve miq dhe bamirës të dashur, ju mundësojmë ta jepni kontributin përmes xhirollogarive bankare.

## Faleminderit!



**Ti që e do Nënë Terezën dhe ndërtimin e Katedrales, uroje, ndihmoje, realizoje, duke thirrur në numrin**

**0900-901-101**



EUR: 1501 090000 1990 20  
USD: 1501 090000 3765 30  
CHF: 1501 090000 3764 33

| Valuta | Banka                                 | Shteti          | SWIFT/BIC   |
|--------|---------------------------------------|-----------------|-------------|
| EUR    | Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG | Vienna, Austria | RZBAATWW    |
| USD    | American Express Bank, LTD            | New York, US    | AEIBUS33    |
| CHF    | UBS AG                                | Zurich, CH      | UBSWCHZH80A |



# PRITA

"Dörtü haftın  
kudrê erîsînê  
kur nêşîyon."

**E PËRMUAJSHMË FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE**  
Pristina • Shkurt 2006 • Viti XXXI • Nr. 2 (total) • Çmimi: 80000 L. • Korrespondent: SHKËRRI



**KRENNET** -  
Kuhle warte, bis  
die Hamirde/



Figure 1b shows the results of the regression analysis. The regression equation is  $y = 0.0001x + 0.0001$ , where  $y$  is the number of fish per 100 m<sup>2</sup> and  $x$  is the number of fish per 100 m<sup>2</sup>. The regression coefficient is 0.0001, which is very close to 1, indicating a strong positive correlation between the number of fish per 100 m<sup>2</sup> and the number of fish per 100 m<sup>2</sup>. The regression equation is  $y = 0.0001x + 0.0001$ , where  $y$  is the number of fish per 100 m<sup>2</sup> and  $x$  is the number of fish per 100 m<sup>2</sup>. The regression coefficient is 0.0001, which is very close to 1, indicating a strong positive correlation between the number of fish per 100 m<sup>2</sup> and the number of fish per 100 m<sup>2</sup>.



1. **Einleitung:** Begrüßung der Teilnehmer, Vorstellung des Moderators, Zielsetzung der Veranstaltung.



**Kryqi** – shprehje dashurie dhe faljeje

■ **Investigate.**  
How much? **\$250,000**

[illegible][illegible]

**Shënimi dhe shënimi**

Chirurgien  
Sanku GORRUP

**Figurat e ndritshme  
heptare: inspirim për një  
kulturë të shëndoshë**